



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 590 Akti

Nr. 678 Vendimi
Tiranë, më 20.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 16.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla Ovale, kati i parë, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Vitjuna Mata**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në

tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Vitjuna Mata, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata ushtron detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit në periudhën 7.9.2015 – 11.10.2016 është emëruar prokurore në stazh pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa nga data 11.10.2016 dhe, në vijim, është emëruar prokurore pranë po të njëjtës prokurori.

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me bashkëshortin F. T., në datën 7.10.2015¹.

3. Subjekti i rivlerësimit u shortua në datën 15.6.2020 dhe do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine (kryesuese), Firdes Shuli (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhguese ndërkombëtare u caktua znj. Marie Tuma.

4. Me vendimin e datës 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Vitjuna Mata për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; rivlerësimi i aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike², ku iu komunikua përbërja e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit nëse do të kishte me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues³.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Vitjuna Mata, si dhe njoftimin e saj për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

¹ Sipas certifikatës së lëshuar nga ZGJC-ja e Njësisë Bashkiake Nr. ***, me datë 24.6.2020, certifikatë e depozituar bashkë me pyetësorin standard.

² Subjekti u njoftua po në datën 2.7.2020 me anë të postës elektronike, me *email* (tek pyetësori standard).

³ Përgjigjja e subjektit me anë të postës elektronike dërguar Komisionit në datën 24.7.2020.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 26.5.2023⁴ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 12.6.2023. Subjekti i rivlerësimit brenda afatit të lënë nga Komisioni ka depozituar pranë zyrës së protokollit të Komisionit shpjegimet dhe provat përkatëse.

9. Subjekti i rivlerësimit, në fillim të hetimit administrativ datë 24.7.2020, me anë të postës elektronike parashtroi një kërkesë drejtuar Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, me arsyetimin se nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016.

9.1 Në kërkesën e saj⁵, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se Prokurori i Përgjithshëm ka kryer verifikimet përkatëse për secilin nga magjistratët e diplomuar në vitin 2016, në përputhje me ligjin nr. 96/2016. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në periudhën e rivlerësimit ajo nuk ka qenë prokurore në detyrë, por kandidate për magistratë dhe, meqenëse procesi i verifikimit është kryer nga Prokurori i Përgjithshëm përpara caktimit të saj në pozicionin e prokurores, ajo nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016.

9.2 Marrja në shqyrtim dhe kryerja sërish e procedurës për marrjen e titullit “Magjistrat”, që parashikohet në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, do të cenonte parimin e “sigurisë juridike” dhe parimin e “gjësë së gjykuar”. Në fund, subjekti ka shpjeguar se është e gatshme për bashkëpunim dhe duke mos pasur asnjë arsye për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit nëse nga ana e Komisionit do të konsiderohej subjekt i ligjit nr. 84/2016, kërkon që të merret një vendim në lidhje me kërkesën e saj. Subjekti deklaroi se pret qëndrimin e Komisionit, ashtu siç ka vepruar ky i fundit në raste të tjera të ngjashme me vendimet nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***⁶.

10. Komisioni, në datën 14.10.2022, me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit se me shumicë votash ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe vijimin e procesit të rivlerësimit. Komisioni vendosi të vijojë procesin e rivlerësimit, për arsyet e mëposhtme:

i) Neni 179/b i Aneksit të Kushtetutës, në përcaktimin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, përfshin të gjithë prokurorët dhe kategoritë e tjera, pa bërë asnjë specifikim, ndarje në nënkategori apo dallim midis prokurorëve në detyrë dhe atyre jo në detyrë.

ii) Ligji nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 17 përcakton: “*Emërohet prokuror në njërën nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë personi i cili, ndër të tjerash, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës*”. Në nenin 23 të po këtij ligji parashikohet: “*Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e 2-të të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në prokuroritë sipas nevojave që kanë këto të fundit*”.

⁴ Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike, me *email*.

⁵ Kërkesë të cilën e depozitoi bashkë me pyetësorin standard pranë protokollit të Komisionit, me datë 22.9.2020.

⁶ Për detaje, shihni kërkesën e subjektit në dosje.

iii) Në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij përcaktohet: “*Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare, që përbëhet nga: (a) një vit program teorik më lëndë të ndryshme të së drejtës; (b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë; (c) një vit praktik me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional*”. Po ashtu, ky ligj në nenin 19 të tij përcakton: “*Në përfundim të periudhës së parashikuar në germën “b” të nenit 14 të tij, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin përkatësisht të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm*”.

iv) Subjekti Vitjuna Mata, në vitet 2013 – 2015, ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës.

v) Me anë të Dekretit Nr. 9220, datë 7.9.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, subjekti është emëruar prokurore në stazh aktiv (magjistrate candidate) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën shtator 2015 – tetor 2016.

vi) Me Dekretin Nr. 9758, datë 11.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është emëruar prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, funksion që ushtron edhe aktualisht.

vii) Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese në gusht të vitit 2016, znj. Vitjuna Mata ka qenë prokurore në stazh. Stazhi si prokuror/e i/e përkohshëm/me, sipas ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, kryhet në vitin e 3-të të Shkollës së Magjistraturës dhe e vendos kandidatin në kushtet e ushtrimit të funksionit në detyrën e prokurorit, edhe pse me emërim të përkohshëm.

viii) Ligji nr. 96/2016, në dispozitat e tij tranzitore, nenet 164 dhe 169 të tij, e lidh qëndrimin e subjekteve në detyrë me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

ix) Përveç sa më sipër, subjekti, me vullnetin e saj të plotë e të pavesuar, në zbatim të detyrimeve si subjekt rivlerësimi *ex officio*, ka përmbushur detyrimet e cituara shkurtimisht në dispozitat e mëposhtme: (a) ka plotësuar deklaratën e pasurisë sipas pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së*”; (b) ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës sipas pikës 1 të nenit 35 të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë DSIK-së*”; (c) ka plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional sipas pikës 1 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale*”.

10.1 Në përfundim, bazuar në sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se znj. Vitjuna Mata është subjekt rivlerësimi sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.6.2023, u ftua në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 16.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, Tiranë.

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit Vitjuna Mata u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e saj dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Vitjuna Mata ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, duke vlerësuar edhe hetimin e kryer nga organet e tjera ndihmëse, por pa u ndikuar nga konstatimet përfundimtare të tyre.

15. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

16. ILDKPKI-ja⁷, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2015, me nr. indeksi ***, në përfundim të veprimeve verifikuese ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

⁷ Raporti nr. *** prot., datë 5.12.2019, i ILDKPKI-së.

17. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njoftohen rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

❖ **Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting***

1. Shtëpi banimi me sip. 64 m², ndodhur në *, h. ***, ap. ***, Durrës⁸**, me vlerë 1,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kontratë dhurimi datë 11.12.2015⁹, ndërmjet dhuruesve M. e E. M. (prindërit e subjektit) dhe pranuese e dhurimit Vitjuna Mata.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 (në vijim DIPP), me burim kontratën e dhurimit datë 11.12.2015. Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e dhurimit me të cilën u përfitua ky apartament.

1.2 Nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së, me datë 20.9.2022, konfirmohet pasuria e llojit apartament, me sip. 64 m², me nr. pasurie ***, e ndodhur në z. k. ***, në adresën ***, shk. ***, ap. ***, Durrës, regjistruar në emër të znj. Vitjuna Mata, me pjesë takuese 100%.

1.3 Për shkak të kësaj marrëdhënieje dhurimi, prindërit e subjektit të rivlerësimit klasifikohen në kategorinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, ata duhet të justifikojnë ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për blerjen e pasurisë së dhuruar prej tyre subjektit.

1.4 Analizë e burimit të krijimit të apartamentit me sip. 64 m², blerë në vitin 2006 me çmimin 1,000,000 lekë

1.4.1 Fillimisht apartamenti është blerë me kontratën e datës 7.12.2006¹⁰ nga babai i subjektit M. M. shtetasit V. Dh., me çmimin 1,000,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.4.2 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 1,000,000 lekë, me të cilën u ble apartamenti, në pyetësorin nr. 2 subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave kanë qenë: (a) paga e prindërve të saj M. e E. M., ku subjekti ka depozituar dokumentacionin e të ardhurave të pagës së tyre¹¹; (b) të ardhurat nga shitja e shtëpisë, sipas kontratës datë 19.12.2003¹², ku shtetasi M. M. bashkë me dy bashkëpronarë e kanë shitur me çmimin 3,800,000 lekë dhe secili ka përfituar 1/3 pjesë, në shumën 1,266,666 lekë.

⁸ Ndodhur në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

⁹ Kontratë dhurimi nr. ***, datë 11.12.2015.

¹⁰ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2006, e depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, por ndodhet edhe tek dokumentacioni i përfituar nga sistemi i ASHK-së.

¹¹ Vërtetim “Për pagën e vlerësueshme”, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për shtetasin M. M., për periudhën tetor 1997 – 2006; vërtetim nr. *** prot., datë 27.11.2020, i shoqërisë “****”, për të ardhurat si Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “****” sh.a., për shtetasin M. M., për periudhën prill 1999 – nëntor 2005; vërtetim nr. *** prot., datë 26.3.2019, i ISSH-së, “Mbi pagën”, të shtetasës E. M., për periudhën shtator 1998 – dhjetor 2005; vërtetim nr. *** prot., datë 27.3.2019, i ISSH-së, “Mbi pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, të shtetasës E. M., për periudhën janar 2006 – shtator 2006.

¹² Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.12.2003, me shitës bashkëpronarët M. M., V. M. dhe Xh. T., të cilët i shesin pasurinë truell me sip. 200 m², nga kjo 95 m² ndërtesë, ndodhur në lagjen “****”, Lushnjë, blerësit A. B., kundrejt çmimit 3,800,000 lekë.

1.4.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja¹³ rezulton se babai i subjektit, z. M. M., me kontratën e datës 13.3.2004¹⁴ ka blerë nga bashkëpronarët K. (14 bashkëpronarë) apartamentin me sip. 105 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për çmimin 3,800,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më pas ky apartament, me kontratën e datës 12.10.2005¹⁵, i është shitur blerësve K. e F. B., për çmimin 7,500,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.5 Me pyetësin nr. 6 subjekti është pyetur për apartamentin me sip. 94.18 m², të ndodhur në S. dhe shtesën prej 57 m² në pronësi të babait të saj, sipas përgjigjes nga ASHK-ja. Subjekti ka shpjeguar se ky apartament është blerë me kontratën e datës 5.9.2015¹⁶, për çmimin 83,580 euro, që përkon me periudhën para fillimit të stazhit profesional. PAGESA për blerjen e apartamentit është kryer në periudha të ndryshme kohore. Prindërit e subjektit kanë sqaruar se, me sa mbajnë mend, kanë kryer pagesat si vijon: (i) 6,500,000 lekë kanë paguar deri në vitin 2009. Konkretisht, 1,000,000 lekë në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes¹⁷ dhe 5,500,000 janë paguar në vitin 2008 – 2009. Burim për kryerjen e pagesës kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit, sipas kontratës së shitjes datë 12.10.2005; (ii) pjesa tjetër e pagesës është kryer në vitin 2015, përpara hartimit të kontratës së shitblerjes datë 5.9.2015. Burim për kryerjen e pagesës kanë shërbyer: (a) kursimet familjare ndër vite; (b) huaja në vlerën 1,500,000 lekë, marrë nga babai i saj prej shtetasit M. B., me të cilin ka marrëdhënie miqësore disavjeçare. Huadhënësi të ardhurat për huadhënien i ka siguruar nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi, sipas kontratës noteriale datë 7.12.2011¹⁸. Në momentin e fillimit të stazhit profesional dhe aktualisht prindërit kanë banuar në apartamentin e ndodhur në S..

1.5.1 Subjekti ka bashkëlidhur kontratën e shitblerjes datë 5.9.2015, për blerjen nga babai i subjektit nga shoqëria ndërtuese të pasurisë së llojit apartament me sip. 94.18 m² + 63.7 m² verandë, i ndodhur në S., si dhe të shtesës prej 57 m², për çmimin 85,580 euro. Si burim i të ardhurave për blerjen e apartamentit me sip. 94.18 m² me 85,580 euro ka shërbyer shitja e apartamentit me sip. 105 m² në datën 12.10.2005¹⁹, me çmimin 7,500,000 lekë.

1.6 Komisioni, nëpërmjet postës elektronike, në datën 16.5.2023 i ka kërkuar noteres D. P. kontratën e sipërmarrjes datë 20.3.2006, e cila me anë të postës elektronike datë 18.5.2023 dërgoi kontratën e porosisë datë 20.3.2006.

1.6.1 Në kontratën e porosisë datë 20.3.2006 përcaktohet ndërtimi i apartamentit me sip. 139.3 m² nga shoqëria “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 83,580 euro, që do të paguhej si në vijim: *“Porositësi parapagoi këstin e parë, sot, me datë 18.3.2006, në vlerën 3,000 euro; këstin e dytë me datë 20.3.2006, në vlerën 37,000 euro; këstin e tretë me datë 20.8.2006, në vlerën 15,000 euro; këstin e katërt me datë 30.12.2006, në vlerën 15,000 euro; dhe këstin e pestë me datë 30.3.2007, në vlerën 12,000 euro”*.

1.6.2 Komisioni, referuar të ardhurave të mësipërme të deklaruara si burim krijimi për blerjen e apartamentit të dhuruar, ka kryer analizën financiare të familjes së subjektit bazuar në

¹³ Përgjigje nr. *** prot., datë 23.3.2021, e ASHK Tirana Jug, dërguar Komisionit.

¹⁴ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.2004.

¹⁵ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2005.

¹⁶ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.9.2015.

¹⁷ Në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.9.2015, citohet kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2006.

¹⁸ Kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2011.

¹⁹ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2005, ku shtetasi M. M. i shet shtetasve K. dhe F. B. apartamentin me sip. 105 m², për çmimin 7,500,000 lekë.

metodologjinë kumulative nga viti 1997, kur janë dokumentuar të ardhurat e prindërve, deri në datën 7.12.2006, nga e cila duket se ka një balancë pozitive në shumën 8,327,448 lekë. Në këtë analizë, Komisioni, për blerjen e apartamentit me sip. 94.18 m², me kontratën e porosisë së datës 20.3.2006, ka llogaritur pagimin e kështit të parë sipas deklarimit të subjektit, në shumën 1,000,000 lekë.

1.6.3 Komisioni, edhe nëse do të merrte për bazë pagimin e kësteve sipas kontratës së porosisë së datës 20.3.2006 dhe më konkretisht nëse do të llogariste si pagesë kështit të parë jo 1,000,000 lekë, sipas deklarimit të subjektit, por vlerën 3,000 euro, paguar në datën 18.3.2006, 37,000 euro në datën 20.3.2006 dhe 15,000 euro në datën 20.8.2006 (në total 55,000 euro ose 6,757,950 lekë), përsëri prindërit e subjektit do të rezultonin me balancë pozitive në vlerën 2,569,498 lekë, deri në fund të vitit 2006, sipas tabelës më poshtë.

Tabela nr. 1 – duke përfshirë shumat 3,000 euro, 37,000 euro dhe 15,000 euro, sipas kontratës së porosisë

Përshkrimi	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Total
Të ardhura	48,192	290,796	606,362	643,295	741,020	1,264,443	2,515,343	1,369,983	9,110,545	1,221,680	17,811,658
Të ardhurat e babait	48,192	231,904	377,168	441,977	468,393	879,360	889,425	983,821	1,127,868	873,708	13,598
Të ardhurat e nënës		58,892	229,194	201,318	272,627	385,083	359,251	386,162	482,677	347,972	2,723,176
Të ardhura nga shijtja e ap.							1,266,667		7,500,000		
Shpenzime	31,807	191,925	400,199	432,000	375,456	375,456	375,456	375,456	438,228	438,228	3,434,211
Shpenzime jetike për 4 persona	31,807	191,925	400,199	432,000	375,456	375,456	375,456	375,456	438,228	438,228	
Pasuri	0	0	0	0	0	0	0	3,800,000	250,000	7,757,950	11,807,950
Apartament 64m ² në ***										1,000,000	1,000,000
Apartament në *** blerë 13.3.2004, shitur 12.10.2005								3,800,000			3,800,000
Automjet M*** blerë 2005, shitur 2012									250,000		250,000
Pagesë për blerje apartamenti 94,18 m ² në *** sipas kontratës së sipërmarjes 20.3.2006										6,757,950	6,757,950
Mundësi për kursime	16,385	98,871	206,163	211,295	365,564	888,987	2,139,887	-2,805,473	8,422,317	-6,974,498	2,569,498
Mundësi për kursime kumulative	16,385	115,256	321,419	532,713	898,277	1,787,265	3,927,152	1,121,678	9,543,996	2,569,498	2,569,498

Në përfundim rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë apartament me sip. 64 m², të dhuruar nga prindërit e saj dhe personat e tjerë të lidhur dhe se prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultuan me burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në datën 7.12.2006, në shumën 1,000,000 lekë.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz 250TD”, i vitit 1992, me targë ***, blerë me kontratën e datës 17.12.2013²⁰ me çmimin 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: shuma për blerjen e automjetit është dhuruar nga bashkëshorti.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

2.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë automjet në deklaratën para fillimit të detyrës (në vijim DPDFD) të vitit 2015 me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*.

2.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor²¹ (në vijim DPSHTRR) konfirmon të regjistruar në emër të subjektit automjetin tip “Mercedes-Benz 250TD”, i vitit 1992, me targë ***, përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 17.12.2013. Shitësi M. Q. e kishte përfituar më parë këtë automjet nga kontrata e shitjes datë 18.7.2007²², me çmimin 250,000 lekë.

²⁰ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.12.2013, me shitës M. Q. dhe blerës Vitjuna Mata.

²¹ Përgjigje nr. ***, datë 19.2.2021, e DPSHTRR-së drejtuar Komisionit.

²² Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.7.2007, me shitës A. D. dhe blerës M. Q.

2.3 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi me shtetasin M. Q. dhe nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë²³.

2.4 Analizë e burimit të krijimit të shumës 200,000 lekë të blerjes së automjetit

2.4.1 Në momentin e dhurimit të shumës 200,000 lekë nga bashkëshorti i ardhshëm i subjektit të rivlerësimit, që përkon edhe me blerjen e automjetit nga ana e subjektit, bashkëshorti i subjektit klasifikohet në kategorinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, ai duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për dhurimin e kësaj shume subjektit të rivlerësimit. Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të specifikojë burimin e krijimit të shumës 200,000 lekë, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e kësaj shume. Subjekti ka shpjeguar se burimi i shumës 200,000 lekë janë kursimet e bashkëshortit F. T. për periudhën 2011 – 2013. Të ardhurat e bashkëshortit F. T. janë: (i) të ardhurat nga paga në aktivitetin tregtar me NIPT ***; (ii) fitimi vjetor në vitet 2011 – 2013.

2.4.2 Subjekti ka bashkëngjitur dokumentacionin provues në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit (vërtetime për punësimin nga ISSH-ja, vërtetim nga Bashkia Tiranë etj.)²⁴.

2.4.3 Komisioni vëren se nga dokumentacioni i depozituar në lidhje me të ardhurat nga pagat provohet pagesa e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për pagën e deklaruar si i vetëpunësuar.

2.4.4 Në lidhje me të ardhurat nga fitimi vjetor në vitet 2011 – 2013 për aktivitetin tregtar, për të cilin subjekti ka depozituar situatën financiare të TVSH-së së personit fizik në intervalin kohor 2010 – 2014, Komisioni iu referua përgjigjes së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë²⁵ (në vijim DRT), e cila për periudhën 2011 – 2013 konfirmon të dhënat tatimore, ku fitimi pas tatimit në total për këtë periudhë është 922,834 lekë²⁶.

2.4.5 Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e bashkëshortit të subjektit për t'i dhuruar shumën 200,000 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit në datën 17.12.2013. Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për dhurimin e shumës 200,000 lekë.

Tabela nr. 2

	Përshkrimi	2011 – 2013
Nr.	Të ardhurat	1,949,402
1	Të ardhura nga paga e F. T.	644,365
2	Të ardhura nga aktiviteti	922,834
3	Të ardhura nga interesat bankarë	382,203
	Detyrime	0
	Shpenzime	608,881

²³ Përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar Komisionit.

²⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 24.01.2023, e ISSH-së, për shtetasin F. T., për periudhën janar 2010 – dhjetor 2012 (për të vërtetuar pagën e përfituar nga bashkëshorti F. T. në vitin 2011); vërtetim “Për bazën e vlerësuar”, datë 23.1.2023, të ISSH-së, për shtetasin F. T., për periudhën janar 2012 – dhjetor 2022 (për të vërtetuar pagën e përfituar nga bashkëshorti F. T. në vitin 2012 – 2013); vërtetim nr. *** prot., datë 28.2.2020, i Bashkisë Tiranë; situata financiare e TVSH-së, për personin fizik “F. T.”, me NIPT ***, për periudhën 2010 – 2014.

²⁵ Përgjigje nr. *** prot., datë 12.10.2022, e DRT-së Tiranë, drejtuar Komisionit.

²⁶ Viti 2011 – qarkullimi = 3,480,607 lekë – fitimi = 104,468 lekë – fitimi pas tatimit = 94,021 lekë; viti 2012 – qarkullimi = 3,403,563 lekë – fitimi = 195,607 lekë – fitimi pas tatimit = 176,046 lekë; viti 2013 – qarkullimi = 3,237,897 lekë – fitimi = 725,297 lekë – fitimi pas tatimit = 652,767 lekë.

1	Shpenzime jetike për 1 person	418,668
2	Shpenzime TIMS	190,213
	Pasuri	3,593,833
1	Dhuruar 200,000 lekë për blerje automjeti, datë 17.12.2013	200,000
2	Ndryshim likuiditeti	3,393,833
	Mundësia për kursime	-2,253,312

2.5 Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e shumës 200,000 lekë të dhuruar nga bashkëshorti i ardhshëm në datën 17.12.2013 për blerjen e automjetit. Për këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se bashkëshorti ka jetuar në një ekonomi të përbashkët me prindërit e tij. Lëvizjet e llogarive bankare, shtesat/pakësimet në këto llogari kanë ndodhur edhe si rezultat i transaksioneve të ndërsjella që kanë pasur ndërmjet llogarive të pjesëtarëve të familjes. Për këtë periudhë, të ardhurat nga interesat bankarë në familjen e bashkëshortit kanë qenë gjithsej 1,293,186 lekë, nga të cilat vetëm interesa në llogaritë e bashkëshortit kanë qenë 410,687 lekë. Për sa i përket zërit “Ndryshim likuiditeti”, e llogaritur nga Komisioni në shumën 3,393,833 lekë, nuk ka si burim të ardhurash vetëm kursimet nga puna e tij sepse nga analiza e gjendjeve dhe transaksioneve në llogaritë bankare rezulton që bashkëshorti ka pasur transaksione me babain e tij.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

2.7 Komisioni vëren se pas prapësimeve rezulton se në llogaritë bankare në BKT²⁷ të F. T. si person fizik janë bërë transfertat hyrëse dhe dalëse nga babai i tij B. T.. Komisioni ka hartuar analizën financiare, duke u shtrirë deri tek pasuritë e bashkëshortit të saj, pasi është mbështetur në deklaratimet e subjektit se si burim kanë qenë të ardhurat nga aktiviteti i tij privat dhe jo të ardhurat e familjarëve të bashkëshortit të saj.

2.7.1 Në rrethanat e evidentuara së fundmi në llogaritë bankare të bashkëshortit si person fizik janë kryer veprime të ndryshme nga familjarët e tij; analiza financiare e hartuar vetëm për të hetuar mundësinë financiare të bashkëshortit nga aktiviteti i tij privat nuk duhet të përfshijë likuiditetet familjare. Për këto arsye, duke qenë se jemi në periudhën para marrjes së detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe para lidhjes së martesës me bashkëshortin, Komisioni vendosi të rishikojë analizën financiare të pasqyruar në tabelën nr. 2, të dërguar me rezultatet e hetimit, duke mos përfshirë pasuritë/likuiditetet familjare të bashkëshortit. Nga analiza financiare e rishikuar për automjetin rezulton se janë përfshirë të ardhurat nga interesat dhe mundësia për të kursyer është 758,318 lekë, me balancë pozitive sipas tabelës më poshtë.

Tabela nr. 3

	Përshkrimi	2011 – 2013
Nr.	Të ardhurat	1,567,199
1	Të ardhura nga paga e F. T.	644,365
2	Të ardhura nga aktiviteti	922,834

²⁷ Përgjigja nr. *** prot., datë 7.2.2023, e BKT-së, drejtuar Komisionit.

	Detyrime	0
	Shpenzime	608,881
1	Shpenzime jetike për 1 person	418,668
2	Shpenzime TIMS	190,213
	Pasuri	200,000
1	Dhuruar 200,000 lekë për blerje automjeti, datë 17.12.2013	200,000
	Mundësia për kursime	758,318

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, si dhe personi tjetër i lidhur me të ka burime të ligjshme financiare për dhurimin e shumës 200,000 lekë subjektit të rivlerësimit.

3. Gjendje cash jashtë sistemit bankar në shumën 600,000 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: kursimet nga bursa e Shkollës së Magjistraturës në periudhën 1.10.2013 – 13.10.2015 dhe paga si prokurore në periudhën 2015 – 31.12.2016.

3.1 Në DPDFD-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje cash jashtë sistemit bankar, me datë 8.10.2015, shuma 300,000 lekë, me burim kursim nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, periudha 1.10.2013 – 13.10.2015”. Në DIPP-në e viteve 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram për gjendjen *cash*.

3.2 Me pyetësin nr. 6, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me deklaramet kontradiktore për gjendjen *cash*, deklaruar: 300,000 lekë në DPDFD-në e vitit 2015; 600,000 lekë në deklaramtën *Vetting*; 1,500,000 lekë në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 26.9.2016.

3.2.1 Subjekti, në përgjigje të pyetësit nr. 6, ka shpjeguar se para fillimit të detyrës ka disponuar gjendjen *cash* 300,000 lekë dhe shumën 200,000 lekë, si depozitë në Credins Bank.

3.2.1.1 Në datën 12.5.2016 ka tërhequr *cash* depozitën bankare në Credins Bank, në vlerën 200,000 lekë. Tërheqja e shumës nuk është deklaruar, pasi kjo shumë nuk ka ndryshuar gjatë vitit 2016, pra nuk është shtuar ose pakësuar. Konkretisht, në datën 31.12.2015 ka disponuar shumën 200,000 lekë, të depozituar në Credins Bank. Po ashtu, në datën 31.12.2016 e ka disponuar përsëri këtë shumë gjendje *cash*. Në plotësimin e deklaramtës për vitin 2016 nuk ka deklaruar rritjen e gjendjes *cash* me 200,000 lekë, duke gjykuar se nuk ka të bëjë me shtesë të likuiditeteve të kursyera dhe se transaksioni i tërheqjes së depozitës në Credins Bank është i pasqyruar në nxjerrjen e llogarisë bankare. Në datën 25.5.2016 ka tërhequr *overdraft* nga paga në shumën 150,000 lekë.

3.2.1.2 Nga të ardhurat e vitit 2016 subjekti ka kursyer 0 (zero) lekë dhe, për këtë shkak, në DIPP-në e vitit 2016 është deklaruar se nuk ka ndryshuar gjendja e kursimeve nga të ardhurat e vitit 2016.

3.2.1.3 Në deklaramtën *Vetting* ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 600,000 lekë. Kjo shumë është deklaruar duke u bazuar në gjendjen faktike të gjendjes *cash* në datën 31.12.2016. Konkretisht: (i) 300,000 lekë me burim kursim nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, periudha 1.10.2013 – 31.10.2015 (deklaruar në deklaramtën para fillimit të detyrës); (ii) 200,000 lekë me burim nga tërheqja e shumës së depozituar në Credins Bank; (iii) 100,000 lekë me burim nga tërheqja e *overdraft*-it.

3.3 Në datën 26.9.2016, kur është pyetur në ILDKPKI në lidhje me gjendjen *cash* në banesë në datën 31.12.2015, në përgjigjen e dhënë ka konfirmuar gjendjen *cash* prej 1,500,000 lekësh, sipas deklaramit të kryer në deklaratën para fillimit të detyrës nga bashkëshorti i saj dhe nuk është përgjigjur për gjendjen *cash* në banesë në datën 31.12.2015, pasi në datën 29.9.2016 nuk e mbante mend.

3.4 Sipas deklaramit në deklaratën *Vetting* burim i krijimit të shumës 600,000 lekë janë: (i) kursimet nga Shkolla e Magjistraturës; (ii) paga si prokurore në vitin 2015 – 2016.

3.5 Në lidhje me kursimet nga Shkolla e Magjistraturës, subjekti ka deklaruar në DFPD: (a) shumën 300,000 lekë si gjendje *cash*; (b) një pjesë të depozitës në Credins Bank, në shumën 200,000 lekë (burimi i depozitës: 100,000 lekë nga dhurimi i prindërve dhe 100,000 lekë nga bursa e Shkollës së Magjistraturës).

3.6 Me pyetësin nr. 6, subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave për shumën 100,000 lekë të dhuruar nga prindërit janë kursimet e tyre nga pagat në periudhën 2011 – 2013. Për të provuar deklaramin e saj, subjekti ka depozituar dokumentacion²⁸ ligjor, që konfirmon punësimin e prindërve të saj dhe përfitimin e të ardhurave, të cilat janë të mjaftueshme për të mbuluar shumën e dhuruar.

3.7 Për sa i përket gjendjes *cash* prej 300,000 lekësh, Komisioni ka kryer analizën finaciare nga momenti i përfitimit të të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës (datë 1.10.2013) deri në momentin e marrjes së detyrës (datë 14.9.2015), duke përdorur metodologjinë kumulative. Sipas kësaj analize të përmbledhur në tabelën më poshtë, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive dhe, për këtë arsye, gjendja *cash* prej 300,000 lekësh është krijuar me burime të ligjshme.

Tabela nr. 4

Përshkrimi	2013	2014	14.9.2015	Total
Te ardhura	231 070	629 136	471 852	1 332 058
Të ardhura nga Magjistratura	131 070	629 136	471 852	1 232 058
Të ardhura nga dhurimi i b/sh 200,000	0			0
Të ardhura nga dhurimi i prindërve 100,000	100 000			100 000
Shpenzime	45 071	229 806	196 028	470 904
Shpenzime jetike për 1 person	35 256	219 998	158 862	414 116
Shpenzime udhëtimi	9 815	9 808	37 166	56 788
Pasuri	299 905	163 130	333 890	796 925
Automjet blerë në 12.2013	200 000			200,000
Gjendje cash DFPD		0	300 000	300 000
Ndryshim likuiditeti bankë	99 905	163 130	33 890	296 925
Mundësi për kursime	-113 906	236 201	-58 066	64 229
Mundësi për kursime kumulative	-113 906	122 295	64 229	64 229

3.8 Për sa i përket depozitës bankare në Credins Bank, rezulton se në datën 12.5.2016 subjekti i rivlerësimit e ka mbyllur atë, duke tërhequr të gjithë shumën prej 208,243 lekësh, por nuk ka

²⁸ Vërtetim “Mbi bazën e vlerësueshme”, datë 20.3.2019, të ISSH-së, për shtetasin M. M., për periudhën prill 2010 – dhjetor 2012; vërtetim “Për bazën e vlerësuar”, datë 1.3.2023, të ISSH-së, për shtetasin M. M., për periudhën janar 2012 – janar 2023; vërtetim “Mbi bazën e vlerësueshme”, datë 26.3.2019, të ISSH-së, për shtetasin E. M., për periudhën shkurt 2009 – dhjetor 2012; vërtetim “Për bazën e vlerësuar”, datë 1.3.2023, të ISSH-së, për shtetasin E. M., për periudhën janar 2012 – janar 2023.

deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 as tërheqjen e depozitës dhe as shtesën e kursimeve *cash*. Në këto rrethana, shuma 208,243 lekë nuk mund të ketë shërbyer si burim i shumës 600,000 lekë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.9 Në lidhje me pagën si prokurore për vitet 2015 – 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në DIPP-në e viteve 2015 – 2016 dhe, për këtë arsye, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i shumës 600,000 lekë.

3.10 Në përfundim, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion vetëm 300,000 lekë kursime *cash* për të krijuar shumën 600,000 lekë, sipas burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.11 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në DIPP-në e viteve 2015 – 2016 dhe rezulton me një mungesë burimesh në shumën 300,000 lekë për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 600,000 lekë, të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.12 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, u është referuar shpjegimeve që ka dhënë në përgjigje të pyetësorit nr. 6. Konkretisht, në datën 31.12.2015, subjekti ka disponuar shumën 208,243 lekë, të depozituar në Credins Bank. Po ashtu, në datën 31.12.2016 ka disponuar përsëri të njëjtën shumë gjendje *cash*. Gjithashtu, në datën 25.5.2016 ka tërhequr *overdraft* nga paga në shumën 150,000 lekë. Pikërisht kjo shumë prej 208,243 lekësh dhe tërheqja e *overdraft*-it nga llogaria e pagës në shumën 150,000 lekë ka shërbyer si burim i shumës 600,000 lekë *cash*, të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Mosdeklarimi i tërheqjes së depozitës dhe i *overdraft*-it në DIPP-në e vitit 2016 është lapsus, nuk është bërë në mënyrë të qëllimshme dhe është korrigjuar në deklaratën *Vetting*²⁹.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

3.13 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar deklaratën *Vetting* në datën 27.1.2017, ndërsa DIPP-ja e vitit 2016 është depozituar në ILDKPKI në datën 25.3.2017. Duke qenë se deklarata *Vetting* është plotësuar dhe depozituar në ILDKPKI më përpara në kohë se DIPP-ja e vitit 2016, krijohet bindja se në të subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me vërtetësi gjendjen reale të shumës *cash* të poseduar prej saj. Përveç faktit të deklarimit të saktë në deklaratën *Vetting*, Komisioni merr në konsideratë faktin se konfirmohet tërheqja nga llogaria e pagës pranë Credins Bank në datën 12.5.2016, të shumës 208,242 lekë, si dhe tërheqja në datën 25.5.2016 e shumës 150,000 lekë nga llogaria e pagës në RBAL, elemente këto që provojnë se nuk ka pasur një përpjekje të subjektit për fshehje apo shmangie në deklarim të shumës në fjalë, por një pasaktësi në deklarim, e cila edhe për shkak të vlerës së saj vlerësohet me një peshë minimale në lidhje me konkluzionin e Komisionit mbi kriterin e pasurisë.

²⁹ Vendimi nr. 467, datë 29.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në këtë vendim Komisioni ka vlerësuar se: “3.3 Në deklaratën *Vetting* është deklaruar shitja e këtij automjeti me kontratën nr. ***, datë 10.9.2014, vlera e të cilit është përdorur si burim për blerjen e automjetit me targa ***, trajtuar më lart dhe trupi gjykues vlerësoi se mosdeklarimi i kësaj kontrate në DIPP-në e vitit 2014 është korrigjuar me deklarimin e saj në deklaratën *Vetting*”.

Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i tërheqjes së depozitës në Credins Bank, si dhe *overdraft*-it në DIPP-në e vitit 2016 (si burime të shumës 300,000 lekë, *cash*) është një pasaktësi në deklaram, e cila është rregulluar në deklaratën *Vetting* dhe, e parë veçmas, vlerësohet me një peshë minimale që nuk ndikon aq sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4. Shtëpi banimi në përdorim e ndodhur në lagjen “**”, Vlorë, me pronar shtetasin B. A.** Nuk është bërë kontrata e qirasë në formë shkresore, pasi pronari ndodhet jashtë shtetit. Nuk janë deklaruar shpenzime qiraje.

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 adresën: rruga “****”, nd. ***, h.***, ap. ***, Vlorë. Po kështu, edhe në pyetësin standard ka deklaruar se nga momenti i marrjes së detyrës ka banuar në adresën: lagjja “****”, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, k. ***, Vlorë. Në këtë apartament subjekti ka jetuar në periudhën janar 2016 – dhjetor 2017. Apartamenti ka qenë në pronësi të shtetasit B. A.. Pagesa prej 13,000 lekësh i është dhënë në dorë shtetasit T. S., pasi pronari i banesës B. A. është rezident në shtetin italian.

4.1.1 Subjekti bashkë me pyetësin standard ka depozituar deklaratën noteriale të datës 17.7.2020³⁰, të shtetasve T. e L. S., të cilët kanë deklaruar ndër të tjera se apartamenti ka qenë në pronësi të mikut të tyre B. A., duke specifikuar edhe kohën e dhënies me qira subjektit edhe vlerën e saj.

4.2 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë se në ç’rrethana është njohur me shtetasin B. A., duke dërguar gjeneralitetet e tij dhe në ç’rrethana është njohur me shtetasin T. S., si dhe të shpjegojë lidhjen e saj me shtetasin B. A. dhe aktin e përfaqësimit që kjo shtetase ka vepruar në emër të z. A..

4.2.1 Subjekti ka shpjeguar se me shtetasin B. A. është takuar vetëm një herë. Numri i tij ka qenë i shënuar në njoftimet që ai linte për dhënien me qira të apartamentit në vende publike. Në takim, ky i fundit është paraqitur me shtetasin T. S. dhe pasi ka rënë dakord për çmimin, nga shtetasi B. A. i është shpjeguar se përmbushja e dyanshme e detyrimeve në vijim do të bëhet me shtetasin T. S.. Me shtetasin B. A. nuk vazhdon komunikimi. Të dhënat e sakta të tij janë B. A., me atësi I. dhe amësi V., i datëlindjes 11.3.1978. Subjekti ka bashkëngjitur edhe certifikatën e martesës së këtij shtetasi.

4.3 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi me shtetasin T. e Z. S. dhe B. A. dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë³¹, ku nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

4.4 Komisioni, gjithashtu, në kuadër të heqjes së çdo dyshimi për përfshirje të shtetasit B. A. në veprimtari të kundërligjshme, ka kryer hetime të mëtejshme, si vijon:

- Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana³² konfirmon se shtetasi i lartpërmendur nuk është person në kërkim ndërkombëtar dhe nuk ka informacion në arkiv për përfshirje të tij në aktivitet kriminal jashtë shtetit.

³⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.7.2020, me deklarues T. e L. S..

³¹ Përgjigjja nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar Komisionit.

³² Përgjigjja nr. ***, datë 25.4.2023, e Interpol Tirana, drejtuar Komisionit.

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar³³ konfirmon se nuk rezulton që ndaj këtij shtetasi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar³⁴ konfirmon se nuk rezulton të ketë vendime penale për shtetasin B. A., si dhe nuk ka aktualisht në gjykim në ngarkim të këtij shtetasi.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë³⁵ konfirmon se nga verifikimi i të dhënave për personat e dëmtuar/kallëzuar nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal ndaj shtetasit B. A..

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e banesës së përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/BASHKËSHORTI F. T.

Personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti F. T. në deklaratën Vetting ka deklaruar pasuritë si vijon:

5. Automjet tip “Mercedes-Benz E270 CDI” i vitit 2003, me targa ***, blerë në vitin 2010, me vlerë 8,500 euro (5,000 euro + 3,500 euro dogana dhe shpenzime të tjera). Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet nga veprimtaria tregtare e regjistruar në QKB, datë 20.10.2005, me NIPT ***.

5.1 Ky automjet është deklaruar nga bashkëshorti F. T. në DPFID-në e vitit 2015 me të njëjtat të dhëna me atë të deklaratës *Vetting*.

5.2 Rezulton që kjo pasuri të jetë krijuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit përpara se ai të lidhej në martesë me subjektin dhe përpara fillimit të detyrës nga ana e subjektit.

5.3 DPSHTRR-ja³⁶ ka konfirmuar të regjistruar automjetin tip “Mercedes-Benz E270” në emër të z. F. T., të përfutur nga kontrata e shitblerjes e datës 8.11.2010³⁷ për çmimin 500,000 lekë të likuiduar mes palëve. Në dokumentin doganor të datës 22.11.2010 pasqyrohet taksa doganore në vlerën 383,925 lekë, e paguar nga z. F. T. sipas mandatpagesës së datës 22.11.2010 të Raiffeisen Bank.

5.4 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, i kërkoi shpjegime subjektit për mospërputhjen në deklarin të vlerës së mjetit të deklaruar në deklaratën *Vetting* 8,500 euro (5,000 euro + 3,500 euro), ndërsa kontrata e shitblerjes pasqyron çmimin 500,000 lekë + taksa doganore 383,925 lekë = 883,925 lekë.

5.4.1 Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se vendosja e shumës 8,500 euro në vend të shumës 883,925 lekë është gabim material dhe mospërputhja ka ndodhur pasi bashkëshorti në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nuk dispononte dokumentet (kontratën + dokumentin doganor) dhe vlera është vendosur me përafërsi.

³³ Përgjigja nr. *** prot., datë 27.4.2023, e PPKKKO-së drejtuar Komisionit.

³⁴ Përgjigja nr. *** prot., datë 28.4.2023, e GJPSHPKKO-së, drejtuar Komisionit.

³⁵ Përgjigja nr. *** prot., datë 5.5.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar Komisionit.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021, e DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

³⁷ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 8.11.2010, me shitëse B. K. dhe blerës F. T. për çmimin 500,000 lekë.

5.5 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi me shitësen e automjetit B. K. dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë³⁸, ku nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

5.6 Analizë burimit të krijimit të shumës 883,925 lekë të blerjes së këtij automjeti

5.6.1 Komisioni në analizën e burimit të krijimit të automjetit ka mbajtur në konsideratë kohën e kryerjes së pagesave, ku çmimi i mjetit është paguar më 8.11.2010 dhe vlera doganore është paguar më 22.11.2010.

5.6.2 Nga të dhënat tatimore të disponuara³⁹ rezulton se për periudhën 2006 – nëntor 2010 subjekti tregtar ka realizuar një fitim në vlerën 1,403,335 lekë. Nga kjo vlerë janë zbritur shpenzimet jetike për një individ në shumën 508,032 lekë⁴⁰ dhe pasuritë e krijuara deri në nëntor të vitit 2010 dhe ka rezultuar se bashkëshorti i ardhshëm i subjektit nuk ka pasur burime të ligjshme në dispozicion për të blerë mjetin me vlerë 883,925 lekë (8,500 euro ose 1,179,885 lekë sipas deklaramentit), pasi analiza financiare është me balancë negative.

5.7 Komisioni mori në analizë si vlerë blerjeje të automjetit vlerën sipas dokumentacionit ligjor prej 883,925 lekësh (çmimi 500,000 lekë + vlera doganore 383,925 lekë) dhe mundësia financiare e tij për të blerë mjetin rezulton si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 5

	Përshkrimi	2006 – nëntor 2010
Nr.	Të ardhurat	2,138,346
1	Të ardhura nga aktiviteti	1,403,335
2	Të ardhura nga paga	735,012
	Detyrime	0
	Shpenzime	508,032
1	Shpenzime jetike për 1 person	508,032
2	Shpenzime TIMS	0
	Pasuri	3,383,925
1	Blerë automjeti Mercedes-Benz 22.11.2010	883,925
2	Ndryshim likuiditeti	2,500,000
	Mundësia për kursime	-1,753,611

5.8 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

a) Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me vlerën e automjetit tip “Mercedes-Benz”, pasi bashkëshorti F. T. në deklaratën e parafillimit të detyrës 2015 dhe në atë *Vetting* ka deklaruar si vlerë 8,000 euro (5,000 euro + 3,500 euro dogana dhe shpenzime të tjera), ndërsa nga

³⁸ Përgjigja nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me shtetasen B. K.

³⁹ DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2022, konfirmon të dhëna tatimore për periudhën 2006 – 2016; DPT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021, ka depozituar kopjen e deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2006, nga ku rezulton se fitimi pas tatimit është 350,000 lekë; Bashkia Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2022, konfirmon se bashkëshorti i subjektit ka likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për periudhën 2006 – 2016, por nuk ka depozituar informacion në lidhje me qarkullimin apo fitimin e realizuar për vitin 2007.

⁴⁰ Për vitin 2007 nuk janë llogaritur shpenzime jetike, pasi nuk janë llogaritur as të ardhura nga aktiviteti privat.

dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja rezulton se automjeti është blerë 500,000 lekë dhe është paguar dogana në vlerën 383,925 lekë.

b) Bashkëshorti i subjektit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën -1,753,611 lekë për mbulimin e shpenzimeve/krijimin e likuiditetit dhe blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 22.11.2010.

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.9 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ka shpjeguar se për mospërputhjen në deklaram për çmimin e automjetit u qëndron të njëjtave shpjegime të dhëna me pyetësin nr. 2 dhe kjo ka ndodhur si pasojë e një gabimi material.

5.10 Ndërsa për burimin e krijimit të shumës 883,925 lekë, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktin se bashkëshorti F. T. dhe familja e tij kanë pasur aktivitet privat familjar që nga viti 1991 dhe bashkëshorti ka qenë edhe administrator i këtij biznesi. Çdo mungesë informacioni nga institucionet tatimore nuk është përgjegjësi e personit fizik që ka shlyer çdo detyrim ligjor e tatimor. Komisioni duhet të marrë në konsideratë edhe fitimin e realizuar për vitin 2007 duke mos e llogaritur atë në vlerën zero sepse ka qenë në varësi të pushtetit lokal. Komisioni duhet të marrë në konsideratë qarkullimin 5-6 milionë/vit për të gjithë periudhën e këtij biznesi sipas përgjigjes së Bashkisë Tiranë. Në vitin 2005 bashkëshorti e ka zhvendosur aktivitetin në Tiranë në dyqanin në pronësi të babait të tij.

5.11 Në lidhje me gjendjen e likuiditeteve në llogarinë e bashkëshortit në vitin 2010 në shumën 2,500,000 lekë, të cilat janë llogaritur si ndryshim likuiditeti në analizën financiare të periudhës 2006 – 2010, bashkëshorti i ka shpjeguar subjektit se këto kursime nuk janë krijuar në periudhën e llogaritur nga Komisioni, por kanë burim të ardhurat nga aktiviteti privat dhe kursimet ndër vite, nga viti 2001 (për 10 vjet). Në analizën financiare janë bërë dhe janë llogaritur kursimet (2,500,000 + 883,925 lekë) për periudhën 10-vjeçare. Nga të dhënat tatimore të disponuara duke përfshirë edhe vitin 2007 rezulton se për periudhën 2006 – 11.2010 subjekti tregtar ka realizuar një fitim në vlerën 1,789,365 lekë. Duke marrë në konsideratë çfarë është sqaruar në paragrafët më sipër, rezulton se bashkëshorti F. T. ka pasur burime të ligjshme në dispozicion për të blerë automjetin me vlerë sipas dokumentacionit ligjor prej 883,925 lekësh (çmimi 500,000 lekë + vlera doganore 383,925 lekë), për kryerjen e shpenzimeve jetike sipas llogaritjeve të Komisionit, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 324,382 lekë.

Vlerësimi i Komisionit është dhënë në pikën 13 të vendimit.

6. Dyqan me sipërfaqe 88.10 m², ndodhur në rrugën “*”, Tiranë⁴¹, blerë me kontratën e datës 22.7.2014⁴², me çmim 70,000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet nga veprimtaria tregtare, regjistruar në QKB datë 20.10.2005, me NIPT ***.**

6.1 Rezulton që kjo pasuri të jetë krijuar nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përpara se ai të lidhej në martesë me subjektin dhe përpara fillimit të detyrës nga ana e subjektit.

⁴¹ Z. k. ***, vol. ***, f. ***, nr. pasurie ***.

⁴² Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 22.7.2014, me shitës A. R. dhe blerës F. T., depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

6.2 Kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshorti F. T. në DPFĐ-në e vitit 2015. Nga dokumentacioni i përfutur gjatë hetimit administrativ rezulton se dyqani i ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, i është blerë shtetasit A. R. me kontratën e shitblerjes datë 22.7.2014, për çmimin 70,000 euro ($88.10 \times 794.55 = 69,999$ euro), vlerë që sipas kontratës është likuiduar tërësisht në vitin 2011.

6.3 Njësia me sip. 88 m^2 konfirmohet nga ASHK-ja⁴³ e regjistruar në pronësi të z. F. T.. Po kështu, edhe Ujësjetllës Kanalizime Tiranë⁴⁴ (në vijim UKT) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal⁴⁵ (në vijim FSHU) konfirmojnë kontrata të lidhura me shtetasin F. T., ***, kabina *** Konstruksion për objektin furrë buke, me adresë: ***, Tiranë.

6.4 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, për njësinë me sip. 88 m^2 i ka kërkuar të japë shpjegime në lidhje me: kohën e kryerjes së pagesës, përse shuma 70,000 euro i ka kaluar z. A. R. si person fizik, duke provuar që kjo pasuri i referohet njësisë me sip. 88 m^2 dhe jo ndonjë pasurie tjetër; të shpjegojë pagesën me datë 17.4.2014 pa asnjë dokument ligjor, ndërkohë që kontrata e shitjes është lidhur 3 muaj më pas, datë 22.7.2014.

6.4.1 Subjekti ka shpjeguar se pagesa për blerjen e njësisë është bërë në datën 17.4.2014 me transaksion bankar. Pasqyrimi se likuidimi është kryer tërësisht në vitin 2011 në kontratën e vitit 2014 është gabim material. Nga biseda me bashkëshortin rezulton se diskutimet dhe marrëveshja për blerjen e njësisë janë bërë me z. A. R. si individ. Nga punonjësja e bankës është shkruar se pagesa prej 70,000 euro kryhet në favor të z. A. R., person fizik, megjithëse nuk ka vendosur asnjë NIPT. Pagesa prej 70,000 euro është kryer vetëm për njësinë me sip. 88.10 m^2 dhe ajo është e vetmja pasuri që bashkëshorti ka blerë nga z. A. R.. Pagesa prej 70,000 euro, me datë 17.4.2014, është kryer sipas kontratës paraprake të shitjes datë 17.4.2014 nga bashkëshorti, e hartuar në formë shkresore. Arsyeja e lidhjes së kontratës së shitjes 3 muaj më vonë, datë 22.7.2014, ka ndodhur për shkak të vonësave në lëshimin e certifikatës së pronësisë nga ZVRPP-ja Tiranë.

6.5 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi me shtetasin A. R. dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁴⁶, ku nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

6.6 Analizë burimit të shumës 70,000 euro si burim i blerjes së dyqanit/njësisë

6.6.1 Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të pasurisë dyqan sipas burimit të deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe kohës së kryerjes së pagesës prej 70,000 euro. Nga veprimet bankare rezulton se pagesa është kryer më 17.4.2014 dhe jo në vitin 2011, siç përcaktohet në kontratën e shitjes së datës 22.7.2014.

6.6.2 Në pikën 5.6 të vendimit kur është analizuar burimi i krijimit të automjetit është konstatuar nga Komisioni se të ardhurat nga veprimtaria tregtare për periudhën 2006 – nëntor 2010 janë konsumuar për blerjen e kësaj pasurie në pjesën më të madhe të tyre, duke rezultuar me një tepriçë prej 11,378 lekësh. Në këto kushte, Komisioni, në analizimin e mundësisë për blerjen e njësisë me sip. 88.1 m^2 , ka marrë në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti privat për

⁴³ ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, drejtuar Komisionit.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021, nga UKT-ja, drejtuar Komisionit.

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2021, nga FSHU-ja, drejtuar Komisionit.

⁴⁶ Përgjigja nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

periudhën dhjetor 2010 – 17.4.2014, të cilat janë në shumën 1,107,490 lekë⁴⁷. Kjo shumë edhe pa zbritur shpenzimet jetike prej 494,219 lekësh është e pamjaftueshme për të mbuluar pagesën prej 70,000 euro ose 9,806,300 lekësh⁴⁸ të kryer më 17.4.2014.

Tabela nr. 6

	Përshkrimi	Dhjetor 2010 – 17.4.2014
Nr.	Të ardhurat	2,227,305
1	Të ardhura nga aktiviteti	1,107,490
2	Të ardhura nga paga	717,971
3	Të ardhura nga interesat bankare	401,844
	Detyrime	0
	Shpenzime	620,266
1	Shpenzime jetike për 1 person	494,219
2	Shpenzime TIMS	190,213
	Pasuri	7,824,250
1	Blerë apartament 17.4.2014, 70,000 euro	9,806,300
2	Dhuruar 200,000 lekë subjektit për blerje automjeti dhjetor 2013	200,000
3	Ndryshim likuiditeti	(2,182,050)
	Mundësia për kursime	- 6,281,377

6.6.3 Nga verifikimi i llogarive bankare në emër të bashkëshortit rezulton se ai ka disponuar shuma të konsiderueshme likuiditetesh duke filluar nga viti 2010, të cilat së bashku me shumën 30,000 euro, të kaluar nga babai i tij B. T., në datën 17.4.2014, ka kryer pagesën 70,000 euro në favor të A. R., person fizik.

6.6.4 Komisioni ka konstatuar se nga verifikimi i llogarive ka rezultuar se shuma 70,000 euro është e përbërë nga të ardhurat e z. F. T. dhe 30,000 euro të kaluara në favor të tij nga babai B. T., ndërkohë në deklaratën *Vetting* personi i lidhur, bashkëshorti F. T., ka deklaruar si burim të shumës 70,000 euro kursimet nga veprimtaria tregtare, regjistruar në QKR në datën 20.10.2005, me NIPT ***.

6.6.5 Me pyetësorët nr. 4 dhe 5 subjektit iu kërkuan shpjegime për mosdeklarimin e shumës 30,000 euro si burim i shumës 70,000 euro, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor ushtrimin e aktivitetit ndër vite të shtetasit B. T., si dhe realizimin e të ardhurave nga ky aktivitet.

6.6.6 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se burim i krijimit të saj është aktiviteti i ushtruar nga i ndjeri, vjehri B. T., me bashkëshortin F. T. dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. B. T. ka filluar ushtrimin e aktivitetit privat që në vitin 1991, i regjistruar me vendim gjykate në vitin 1992, me objekt “artikuj të përzier” me të gjithë pjesëtarët e familjes. Më pas ka vijuar nga viti 1993 deri në vitin 2001 me aktivitete tregtare të ndryshme⁴⁹. Në vitin 2001 aktiviteti ndahet dhe bashkëshorti F. T. e ushtron në mënyrë të veçantë nga i ati. Në vitin 2004 B. T. ka ushtruar aktivitetin privat “prodhime brumi” në ortakëri me të birin F. T. dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Në vitin 2005, z. F. T. e zhvendos aktivitetin në Tiranë. Nga viti 2005 deri më 3.11.2016 aktiviteti “furrë buke” është ushtruar me NIPT *** në dyqanin në pronësi të B. T.. Në datën 3.11.2016 bashkëshorti zhvendos aktivitetin në adresën “****” në dyqanin e blerë në

⁴⁷ Të ardhurat e aktivitetit për muajin dhjetor 2010 (36,030 lekë) + të ardhurat e vitit 2011 (94,021 lekë) + të ardhurat e vitit 2012 (176,046 lekë) + të ardhurat e vitit 2013 (652,727 lekë) + të ardhurat e aktivitetit për 3.5 muaj të vitit 2014 (148,625 lekë).

⁴⁸ Konvertuar sipas kursit të këmbimit të euros të datës 17.4.2014 në BOA, ku 1 euro = 140.09 lekë.

⁴⁹ Shihni me detaje përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

shumën 70,000 euro. Në këtë datë, B. T. ka zhvilluar aktivitetin me NIPT *** në dyqanin në emër të tij, ku më parë kishte zhvilluar aktivitetin bashkëshorti. Shuma prej 30,000 euro nuk ka qenë dhurim, por vlerësim i kontributit të bashkëshortit gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit privat nga babai B. T.. Bashkëshorti F. T. në momentin e blerjes së dyqanit ka bashkëjetuar me prindërit dhe ka pasur ekonomi të përbashkët dhe, për këtë shkak, shuma prej 30,000 euro nuk është deklaruar si dhurim.

6.6.6.1 Subjekti ka shpjeguar gjithashtu⁵⁰ se ka kaluar kohë e gjatë për të cilën kërkohet dokumentacioni ligjor rreth 32 vjet më parë dhe në vazhdim ka qenë e pamundur gjetja e dokumentacionit të plotë ligjor për çdo vit. Nga DRT-ja Berat vërtetohet se familja e bashkëshortit ka ushtruar aktivitet tregtar të ligjshëm që nga viti 1991, por nuk disponojnë të dhëna për të ardhurat e realizuara për çdo vit. I ndjeri B. T. nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për ruajtjen e dokumenteve që vërtetonin të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat etj.

6.6.7 Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të shumës 30,000 euro vendime gjykatash për regjistrimin e B. T. dhe familjarëve të tij (F., F., B. dhe O. T.) si person fizik për ushtrim aktiviteti privat, si dhe leje për ushtrim aktiviteti në emër të B. T. dhe familjarëve të tij⁵¹.

6.6.8 DRT-ja Berat⁵² konfirmon ushtrimin e aktivitetit privat të B. T. dhe familjarëve të tij që në vitet 1990 e në vijim. DRT-ja Berat ka dhënë informacion në lidhje me të ardhurat e parashikuara/realizuara ndër vite nga familjarët e B. T. (B., O., F. dhe B. T.), por nuk jep të dhëna për fitimin e realizuar. Ndodhur në këto kushte, Komisioni ka bërë një përllogaritje hipotetike të fitimit të realizuar duke shumëzuar të ardhurat (e realizuara/deklaruar) me një normë fitimi prej 30%, bazuar në objektin e veprimtarisë “prodhim dhe tregtim të pijeve freskuese, pastičeri dhe artikujve të ndryshëm”. Në vitet kur mungon informacioni për të ardhurat e realizuara, janë marrë si bazë për llogaritjen e fitimit të ardhurat e parashikuara, ndërsa në vitet kur nuk ka të dhëna për të ardhurat është marrë si referencë viti i mëparshëm ose viti më i afërt me informacion.

6.6.9 Nga sa më sipër, duket se të ardhurat e mundshme nga aktiviteti privat për vitet 1991 – 2004 në shumën 1,977,312 lekë nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet jetike për 5 anëtarë në shumën 2,853,508 lekë⁵³ dhe për të kursyer shumën 30,000 euro, dhënë F. T. nga babai i tij në datën 17.4.2014.

6.7 Analizë e shumës 1,000,000 lekë, deklaruar nga bashkëshorti për mobilimin e dyqanit

6.7.1 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti që të specifikojë burimin e shumës 1,000,000 lekë dhe ta provojë atë me dokumentacion ligjor.

6.7.2 Subjekti ka shpjeguar se mobilimi i dyqanit në shumën 1,000,000 lekë është bërë në periudhën nëntor – dhjetor 2016 nga të ardhurat e bashkëshortit të realizuara gjatë vitit 2016 nga ushtrimi i aktivitetit tregtar. Në periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 bashkëshorti ka realizuar të ardhura si administrator në shumën 264,000 lekë dhe fitimin neto në shumën 1,668,797 lekë.

⁵⁰ Shihni për detaje pyetësorin nr. 5.

⁵¹ Shihni dokumentacionin e depozituar me pyetësorët nr. 4 dhe nr. 5.

⁵² Përgjigja nr. *** prot., datë 4.12.2020, e DRT-së Berat, depozituar nga subjekti me pyetësorin nr. 5.

⁵³ Shpenzimet jetike për periudhën 1991 – 1998 janë llogaritur sa 66% e të ardhurave, duke qenë se ato janë në nivelin 800 USD/vit dhe për vitin 1999 janë llogaritur për 800 USD (shihni vendimin e Kolegjit nr. 15/2021 (JR) datë 18.06.2021, paragrafi 21.38), ndërsa për periudhën 2000 – 2004 sipas të dhënave të dërguara nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

Nga këto të ardhura ka shpenzuar shumën 1,000,000 lekë për mobilimin e dyqanit. Në lidhje me të ardhurat nga paga si administrator, subjekti i rivlerësimit deklaroi se pagat janë përfituar *cash*, trajtuar më gjerësisht në pikën 8 të relacionit.

6.7.3 DRT-ja Tiranë⁵⁴ konfirmon fitimin neto të realizuar nga aktiviteti tregtar i personit fizik për vitin 2016, në shumën 1,668,797 lekë. Duket se kjo shumë është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimin prej 1,000,000 lekësh. Gjithashtu edhe nga analiza financiare për vitin 2016 duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë, pasi rezultojnë me balancë pozitive.

6.7.4 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti i saj, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e dyqanit në vitin 2014 me burim të ardhurat nga aktiviteti privat, pasi rezultoi me mungesë burimesh në shumën - 6,281,377 lekë.

Për konstatimin e mësipërm subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.7.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se:

Së pari, kjo është pasuri para martese dhe para fillimit të detyrës (edhe të stazhit profesional) dhe nuk duhet të kualifikohet si person i lidhur apo person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Referuar edhe jurisprudencës së Komisionit⁵⁵, si dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), bashkëshorti F. T. nuk ka pasur asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, të asaj natyre që parashikojnë pikat 13 dhe 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përpara lidhjes së martesës (e cila korrespondon edhe me fillimin e bashkëjetesës ndërmjet subjektit dhe bashkëshortit).

Së dyti, pasuria është në pronësi të plotë të bashkëshortit dhe subjekti nuk disponon të drejta reale mbi to dhe kjo pasuri konsiderohet si pasuri vetjake për efekt të Kodit të Familjes dhe mbetet e tillë edhe pas martese. Gjithashtu, në periudhën para martese subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë vepruar financiarisht në autonomi të plotë dhe në asnjë rast si burim krijimi i këtyre pasurive nuk kanë shërbyer të ardhurat e subjektit. Po kështu, në asnjë rast subjekti nuk ka kryer veprime dhe nuk ka pasur transaksione bankare ose jobankare që kanë lidhje me blerjen e pasurive dhe likuidimin e çmimit të blerjes. Në përfundim, subjekti i kërkon Komisionit se në përputhje me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit veprimet juridike për fitimin e të drejtave reale të pasurive të bashkëshortit i përkasin periudhës para martese dhe nuk duhet të përfshihen në kuadër të vlerësimit të subjektit.

Së treti, duke pasur edhe predispozicionin për të bashkëpunuar me Komisionin subjekti është në pamundësi objektive për të gjetur dokumentacionin e plotë ligjor për të ardhurat e realizuara çdo vit nga bashkëshorti dhe familja e tij i kërkon Komisionit të marrë në konsideratë edhe faktin se ka kaluar një kohë e gjatë, rreth 32 vjet më parë. Subjekti ka shpjeguar se edhe gjatë hetimit administrativ ka depozituar dokumentacion ligjor që vërteton ushtrimin e aktivitetit tregtar nga vjehri B. T. dhe familjarët e tjerë⁵⁶.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2022, drejtuar Komisionit.

⁵⁵ Vendimi i Komisionit nr. 86, datë 17.12.2018, për subjektin A. K. dhe vendimi i Kolegjit nr. 15, datë 18.6.2021, i subjektit K. S.

⁵⁶ Për detaje shihni prapësimet e subjektit në dosje.

Vlerësimi i Komisionit është dhënë në pikën 13 të vendimit.

7. Person fizik i tatueshëm “F. T.”, aktiviteti “furrë buke”, me NIPT *. Vlera: 1,868,797 lekë.** Për periudhën 14.9.2015 – 31.12.2015 fitimi 200,000 lekë; për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 fitimi 1,668,797 lekë.

7.1 Në deklaratat periodike subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti tregtar i tatueshëm i bashkëshortit “furrë buke” me NIPT ***: “*DPFD 2015 të ardhura = 800,000 lekë; DIPP 2015 të ardhura = 200,000 lekë; DIPP 2016 të ardhura = 1,668,797 lekë*”.

7.2 Subjekti i rivlerësimit bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar vërtetimin e DRT-së Tiranë⁵⁷, e cila konfirmon se personi fizik “F. T.”, me NIPT *** dhe administrator po F. T. ka raportuar fitim neto nga shitja e mallrave për vitin 2015 shumën 1,014,265 lekë dhe për vitin 2016 shumën 1,668,797 lekë.

7.3 QKB-ja⁵⁸ konfirmon regjistrimin e F. T. si person fizik me NIPT ***, me aktivitet “furrë buke, prodhime brumi”, i regjistruar me datë 20.10.2005, me adresë të ushtrimit të aktivitetit rruga “***”, pallatet ***, p. ***, k. ***, Tiranë.

7.4 DPT-ja⁵⁹ konfirmon regjistrimin si person fizik “F. T.” me NIPT ***. DPT-ja ka depozituar për personin fizik “F. T.” dokument tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për periudhën 2006, 2014 – 2020, ku fitimi neto për vitin 2015 është 1,014,265 lekë dhe për vitin 2016 është 1,668,797 lekë.

Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti i saj ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin të ardhurat nga aktiviteti tregtar.

8. Administrator i veprimtarisë tregtare me NIPT *. Vlera: 352,000 lekë.** Për periudhën 14.9.2015 – 31.12.2015, fitimi 88,000 lekë; për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 fitimi 264,000 lekë.

8.1 Në deklaratat periodike bashkëshorti F. T. ka deklaruar të ardhura si administrator i personit fizik: “*DPFD e vitit 2015 të ardhura 176,000 lekë; DIPP e vitit 2015 të ardhura 88,000 lekë dhe në DIPP e vitit 2016 të ardhura 264,000 lekë*”.

8.2 Po nga DPT-ja⁶⁰ është depozituar ekstrakti historik i punësimit për periudhën dhjetor 2011 – dhjetor 2020, ku janë të pasqyruara pagesat për sigurimet/tatimi mbi të ardhurat personale për shtetasin F. T..

8.3 Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit nuk rezulton të jenë përfituar me bankë paga nga subjekti fizik tregtar “F. T.”.

8.4 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të provojë përfitimin e pagave për periudhën e deklaruar, si dhe të të gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit nëpërmjet pagesave bankare apo pasqyrave të llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve për personin fizik. Subjekti ka shpjeguar se pagesa e bashkëshortit është bërë *cash*. Subjekti ka depozituar formularin e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2015 – 2016.

⁵⁷ Vërtetimi nr. *** prot., datë 26.1.2017, i DRT-së Tiranë, depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

⁵⁸ Përgjigja nr. *** prot., datë 25.2.2021, e QKB-së, drejtuar Komisionit.

⁵⁹ DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021, drejtuar Komisionit.

⁶⁰ DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021, drejtuar Komisionit.

Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti i saj ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin të ardhurat si administrator i personit fizik.

9. Depozitë bankare në BKT në shumat 5,000 euro dhe 1,500,000 lekë. Vlera: 2,200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) kursimet nga veprimtaria tregtare, regjistruar në QKB me datë 20.10.2005, me NIPT ***; (b) gjendja *cash* jashtë sistemit bankar para fillimit të detyrës së subjektit, deklarues Vitjuna Mata, 1,500,000 lekë; (c) kursime nga fitimi nga veprimtaria tregtare nga data 14.9.2015 deri më 31.12.2015, shuma 200,000 lekë; (ç) kursime nga fitimi nga veprimtaria tregtare nga data 1.1.2016 deri më 31.12.2016, shuma 500,000 lekë.

9.1 Në deklaratën *Vetting*, nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti F. T., ka dhe një sqarim: “*Shtetasi F. T. së bashku me të atin B. T. e kanë filluar aktivitetin tregtar që në vitin 1991. Bashkëlidhur, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar. Nuk mund të përcaktoj saktë të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar, pasi nuk disponoj asnjë dokument për periudhën kohore që shteti nuk kërkonte deklarimin e të ardhurave nga tregtarët*”.

9.2 Subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting*, ka depozituar vendimin nr. ***, datë 15.1.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, ku rezultojnë shtetasit B., F. e B. T., të cilët janë të regjistruar për të ushtruar privatisht aktivitetin “shitës privat të artikujve të ndryshëm”.

9.3 QKB-ja⁶¹ konfirmon regjistrimin e z. F. T. si person fizik me NIPT ***, i regjistruar në datën 16.7.1992, me adresë të ushtrimit të aktivitetit në ***, Berat, i cili deri më 21.2.2021 ka qenë aktiv dhe tani, pas verifikimit në QKB, ka shënimin në faqen zyrtare të saj: “*Ju lutem paraqituni pranë zyrave të QKB-së për të plotësuar të dhënat e subjektit*”. Nga dokumentacioni i QKB-së rezulton edhe vendimi nr. ***, datë 4.11.1991, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, ku konfirmohet regjistrimi i shtetasit B. T. për ushtrimin e veprimtarisë tregtare “prodhim dhe shitje e pijeve freskuese”, si dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar që konfirmon regjistrimin e shtetasve B., F. e B. T. për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të shitjes së artikujve të ndryshëm.

9.4 BKT-ja⁶² konfirmon depozitat me vlerë 1,500,000 lekë dhe 5,000 euro në emër të bashkëshortit të subjektit, të çelura në datën 27.1.2017, në të njëjtën datë me plotësimin e deklaratës *Vetting*.

9.5 Në DPFDF-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit F. T. ka deklaruar: “*Gjendje cash jashtë sistemit bankar në datën 8.10.2015, shuma 1,500,000 lekë me burim kursime nga veprimtaria tregtare e regjistruar në QKR më 20.10.2005, me NIPT ****”. Pjesa takuese: 100%”.

9.6 Komisioni e vlerëson shumën prej 1,500,000 lekësh si pasuri në pronësi vetjake dhe 100% të bashkëshortit të subjektit, z. F. T., të krijuar prej tij përpara fillimit të detyrës së subjektit dhe përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin.

9.7 Komisioni analizoi mundësitë financiare për krijimin me burime të ligjshme të shumës 1,500,000 lekë me të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit. Të ardhurat e aktivitetit, të marra në analizë, i referohen periudhës 17.4.2014 – 14.9.2015 dhe në total janë 1,079,385

⁶¹ QKB-ja me shpresën nr. *** prot., datë 25.2.2021, drejtuar Komisionit.

⁶² Shpresë nr. *** prot., datë 16.2.2021, e BKT-së, drejtuar Komisionit.

lekë⁶³, nga ku 342,224 lekë janë konsideruar shpenzime për një person dhe shuma e disponueshme për të krijuar gjendjen *cash* është 876,291 lekë, duke rezultuar me mungesë burimesh prej 623,709 lekësh për krijimin e gjendjes *cash* 1,500,000 lekë.

Tabela nr. 7

	Përshkrimi	17.4.2014 – 14.9.2015
Nr.	Të ardhurat	1,218,515
1	Të ardhura nga aktiviteti	1,079,385
2	Të ardhura nga paga	139,130
	Detyrime	0
	Shpenzime	342,224
1	Shpenzime jetike për 1 person	314,694
2	Shpenzime TIMS	27,530
	Pasuri	1,500,000
1	Kursime <i>cash</i> 1,500,000 lekë	1,500,000
	Mundësia për kursime	-623,709

9.8 Në lidhje me burimin e depozitës 5,000 euro, për të cilën bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 700,000 lekë kursime nga veprimtaria tregtare (konkretisht 200,000 lekë për periudhën 14.9.2015 – 31.12.2015 dhe 500,000 lekë për vitin 2016), Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar në DIPP-në e viteve 2015 – 2016 kursime *cash* nga veprimtaria tregtare, por në DIPP-në e vitit 2016 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Depozitë bankare në BKT në shumën 500,000 lekë. Burimi: kursimi nga fitimi nga veprimtaria tregtare nga data 1.1.2016 – 31.12.2006*”.

9.9 Komisioni, në pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të identifikojë depozitën duke deklaruar numrin e saj dhe datën e hapjes, si dhe ta provojë atë me dokumentacion ligjor.

9.10 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga ushtrimi i veprimtarisë tregtare për vitin 2016, bashkëshorti ka kursyer gjendjen *cash* në shumën 500,000 lekë. Për efekt të plotësimit të deklaratës *Vetting* (27.1.2017) shuma *cash* prej 500,000 lekësh është bashkuar me kursimet e tjera të bashkëshortit deri në vitin 2016 dhe janë derdhur në BKT në emër të tij. Në momentin e plotësimit të DIPP-së së vitit 2016 (25.3.2017) shuma prej 500,000 lekësh ka qenë e depozituar në bankë. Konkretisht, këto kursime janë derdhur në BKT në shumën 5,074 euro (në llogarinë nr. ***) dhe në llogarinë në lekë në shumën 1,500,000 lekë (në llogarinë nr. ***)

9.11 Nga verifikimi i llogarive bankare në BKT rezultoi se për depozitën me vlerë 5,074 euro, të çelur në datën 27.1.2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* shumat 2,800 euro dhe 2,274.37 euro, të cilat janë transferuar nga një llogari tjetër e tij në BKT.

9.11.1 Burimi i shumës së transferuar prej 2,247 euro është një depozitë e çelur më 17.4.2014 dhe e maturuar më 27.1.2017. Duket se shuma 2,274 euro është krijuar para martese dhe para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe ka ekzistuar në bankë deri më 27.1.2017, por

⁶³ Të ardhurat e aktivitetit për periudhën 17.4.2014 – 31.12.2014 janë përlllogaritur si të ardhura përpjesëtimore për 8.5 muaj të vitit 2014; të ardhurat e aktivitetit për periudhën 1.1.2015 – 14.9.2015 janë përlllogaritur si të ardhura përpjesëtimore për 8.5 muaj të vitit 2015.

nuk është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPFID apo edhe më pas. Në datën 17.4.2014, kur është krijuar depozita prej 2,274 euro, bashkëshorti i ardhshëm i subjektit të rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh (shihni tabelën nr. 6).

9.11.2 Në lidhje me depozitim e shumës 2,800 euro në datën 27.1.2017, për të cilin subjekti deklaroi se janë kursime të bashkëshortit në vitin 2016, nga analiza financiare rezultojnë se ato kanë pasur mundësi financiare për të kursyer shumën 2,800 euro dhe paguar për shpenzimet dhe pasuritë e tjera. Shuma 2,800 euro është konsideruar si kursim *cash* për vitin 2016 me të ardhura nga aktiviteti tregtar, duke marrë në konsideratë faktin se në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar depozitën bankare në BKT.

9.12 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 623,709 lekë për krijimin e depozitës 1,500,000 lekë në datën 27.1.2017 dhe mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2,274 euro për krijimin e depozitës 5,074 euro në datën 27.1.2017.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

9.13 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ka shpjeguar se *për të vërtetuar mundësitë financiare për krijimin me burime të ligjshme të shumës 1,500,000 lekë me të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, nuk ka logjikë që Komisioni të konsiderojë se këto kursime janë krijuar në një periudhë të limituar 17.4.2014 – 14.9.2015. Të ardhurat e aktivitetit tregtar nuk mund të ndahen në raport të drejtë për çdo ditë apo muaj siç i ka llogaritur Komisioni. Të ardhurat nga aktiviteti privat për vitin 2014 deri në shtator të vitit 2015 janë gjithsej 1,443,860 lekë. Komisioni ka vlerësuar se shuma 342,224 lekë është paguar për shpenzime për një person dhe shuma e disponueshme për të krijuar gjendjen *cash* është 876,291 lekë, duke rezultuar me mungesë burimesh prej 623,709 lekësh për krijimin e gjendjes *cash* 1,500,000 lekë.*

Në periudhën për të cilën po bëhet analiza financiare, bashkëshorti më ka shpjeguar që në atë periudhë bashkëjetonte me prindërit dhe ata nuk pranonin që ai të paguante për shpenzimet jetike. Shpenzimet jetike të bashkëshortit janë përballuar me të ardhurat e prindërve të tij nga pensioni dhe biznesi privat, duke i krijuar mundësi bashkëshortit që të kursente më shumë.

Duke marrë në konsideratë të gjitha shpjegimet e sipërcituara rezulton se bashkëshorti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet e deklaruara të shumës 1,500,000 lekë me të ardhurat nga aktiviteti privat, duke rezultuar me një bilanc pozitiv në total 229,460 lekë.

9.14 Komisioni vlerëson se depozita prej 5,000 euro përbëhet nga shuma 2,800 euro, e krijuar me kursime të vitit 2016, për të cilën subjekti dhe bashkëshorti kishin mundësi financiare për ta kursyer, si dhe nga shuma 2,247 euro, e cila e kishte burimin nga një depozitë e çelur në datën 17.4.2014, për të cilën rezultoi që bashkëshorti i subjektit nuk kishte mundësi financiare që ta krijonte. Komisioni mori në konsideratë faktin se kjo shumë është krijuar përpara se subjekti të lidhte martesë ligjore me bashkëshortin dhe para fillimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi në lidhje me pamundësinë financiare të bashkëshortit të saj të ardhshëm, marrë në konsideratë edhe faktin se kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës nga subjekti.

9.15 Ndërsa për shumën 1,500,000 lekë, të krijuar me të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit të marra në analizë për periudhën 17.4.2014 – 14.9.2015, ku bashkëshorti i subjektit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën -623,709 lekë, Komisioni vlerëson se meqenëse edhe këto të ardhura janë krijuar në periudhën kur subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin lidhur martesë ligjore (në datën 7.10.2015) vendosi të mos e ngarkojë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi sa i përket ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe balancës përkatëse financiare.

KONSTATIME TË TJERA

10. Në lidhje me adresën e banimit Njësia Nr. *, rruga “****”, pallatet ***, kulla ***, kati i 9-të, nr. ***, Tiranë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit**

10.1 Subjekti i rivlerësimit, në DPDFD-në e vitit 2015, në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si adresë banimi: “Njësia Nr. ***, rruga “****”, pallatet ***, kulla ***, kati ***, nr. ***, Tiranë”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar të njëjtën adresë, por apartamenti nr. ***. Ndërsa në ILDKPKI ka deklaruar të njëjtën adresë, por apartamenti nr. ***.

10.2 Në pyetëtorin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në momentin e marrjes së detyrës (në vitin 2016 kur është emëruar prokurore me dekret të Presidentit) ka banuar në Tiranë, në adresën Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, k. ***, apartament në pronësi të vjehrrit B. T. dhe nuk ka paguar qira.

10.2.1 Subjekti bashkë me pyetëtorin standard ka depozituar certifikatën e pronësisë datë 19.4.2016 të pasurisë së llojit “apartament” me sip. 84.20 m², ndodhur në z. k. ***, me nr. pas ***, vol. ***, f. ***, Tiranë, h. ***, ap. ***, në pronësi të B. T..

10.3 Komisioni, me pyetëtorin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë në lidhje me adresën e deklaruar prej saj në deklarime të ndryshme, ku numri i apartamentit është deklaruar 67, 68 apo 69. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të depozitojë praktikën e përfitimit të apartamentit nga ana e vjehrrit të saj B. T., ku ka jetuar për disa kohë.

10.3.1 Subjekti ka shpjeguar se adresa Njësia Nr. ***, rruga “****”, pallatet ***, kulla ***, k. ***, nr. ***, nr. *** apo dhe nr. *** i përkasin të njëjtit apartament me nr. pas ***, në z. k. ***, vol. ***, f. ***. Adresat e deklaruara në DPDFD-në e vitit 2015 dhe DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 i referohen adresave të njoftuara nga OSHEE-ja për apartamentin që dispononte vjehri, ku subjekti deklaroi se ka banuar. Subjekti sqaron se për të njëjtin apartament ka mospërputhje të adresës së njoftuar nga OSHEE-ja dhe dokumentacionit ligjor që disponohet për objektin.

10.3.2 Subjekti ka depozituar edhe të gjithë dokumentacionin ligjor të përfitimit të këtij apartamenti⁶⁴ nga vjehri B. T., që daton që nga viti 2001 me kontratë sipërmarrjeje nga ana e ndërtuesit dhe porositësit M. dhe E. XH. E, më pas në vitin 2008, kur ky apartament kalon nga

⁶⁴ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 15.1.2001, me sipërmarrës shoqëria “****” sh.p.k. dhe porositës M. dhe E. Xh.; deklarata noteriale nr. ***, datë 19.8.2008, me deklarues M. dhe E. Xh. dhe B. T., të cilët deklarojnë se B. T. u ka dhënë shumën 6,000,000 lekë si vlerë totale për shitjen e apartamentit me sip. 85 m², i përfituar nga shitësit me kontratën e sipërmarrjes datë 15.1.2001; leje legalizimi nr. ***, datë 9.2.2016, lëshuar në emër të B. T. për apartamentin me sip. 84.2 m²; certifikatë pronësie për apartamentin me sip. 84.20 m² në pronësi të B. T., ndodhur në z. k. ***, me adresë në Tiranë, apartamenti nr. ***.

M. dhe E. XH. në emër të B. T. dhe, më pas në vitin 2016, me legalizim, ku i kalon plotësisht pronësia B. T..

Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarin e adresës së apartamentit.

11. Në lidhje me kontratën e lidhur me FSHU-në nga bashkëshorti i subjektit F. T. në kategorinë “familjare”, në vitin 2011

11.1 Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka konstatuar se në përgjigjen e FSHU-së⁶⁵ përmendet edhe abonenti F. T. për kategorinë “familjare”, kontratë e lidhur në vitin 2011.

11.2 Komisioni, nisur nga fakti i kontratës së lidhur me FSHU-në, në vitin 2011, në kategorinë familjare nga bashkëshorti i subjektit F. T., për të hequr çdo dyshim për ndonjë pasuri të padeklaruar nga subjekti apo personi i lidhur me të, i kërkoi shpjegime me pyetësin nr. 3.

11.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kontrata e lartpërmendur është lidhur për pasurinë e paluajtshme apartament me sip. 113.30 m², me adresë ***, blerë në vitin 2019 prej saj dhe bashkëshortit F. T.. Ky apartament u është blerë shtetasve S. dhe J. Gj.. Data 29.4.2011, e evidentuar në sistemin e FSHU-së, i referohet momentit kur është lidhur për herë të parë kontrata me apartamentin. Në datën 5.10.2020 bashkëshorti F. T. ka bërë kërkesë në OSHEE për ndryshimin e emrit të abonentit nga S. Gj. në F. T..

11.2.2 Subjekti ka depozituar kontratën e datës 25.4.2019, me të cilën ka përfutur apartamentin me sip. 113.3 m² kundrejt çmimit 64,000 euro. Gjithashtu, ka depozituar edhe kërkesën e datës 5.10.2020 të bashkëshortit F. T. pranë OSHEE-së për ndryshimin e emrit të kontratës nga S. Gj. në F. T.. Është depozituar certifikata e pronësisë e datës 28.5.2019 për këtë apartament në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me kontratën e lidhur me FSHU-në për apartamentin e blerë nga subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2019.

12. Analiza financiare 14.9.2015 – 2016

12.1 Nga analiza e DIPP-ve dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 14.9.2015 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

12.2 Komisioni ka kryer edhe analizën financiare para fillimit të detyrës, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy pasuri: gjendje *cash* 300,000 lekë (burim krijimi: të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës) dhe automjet 200,000 lekë në vitin 2013 (burim krijimi: dhurim i bashkëshortit të ardhshëm), nga ku ka rezultuar se për periudhën 2013 – 14.9.2015 subjekti ka një balancë totale pozitive në shumën 64,229 lekë.

12.3 Për pasuritë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, që kanë si burim krijimi të ardhurat e tij nga aktiviteti privat, Komisioni ka kryer një analizë të detajuar për bashkëshortin e saj nga viti 2006 (data e regjistrimit të aktivitetit) deri më 14.9.2015, nga ku ai ka rezultuar me një balancë negative në shumën -8,658,697 lekë.

Për konstatimin e mësipërm subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

⁶⁵ Përgjigja nr. *** prot., 22.2.2021, e FSHU-së, drejtuar Komisionit.

12.4 Subjekti në prapësimet e saj ka paraqitur dokumentacion të konsiderueshëm, që vërteton ushtrimin e aktivitetit tregtar nga ana e familjes së bashkëshortit të saj, përfshirë edhe vetë bashkëshortin, prej vitit 1991 e në vazhdim, si dhe ka shpjeguar duke paraqitur në formë tabelare analizën financiare para fillimit të detyrës për periudhën 2013 – 14.9.2015, ku ka rezultuar me balancë pozitive në vlerën 264,229 lekë, ndërsa për periudhën 14.9.2015 – 31.12.2015 deri në vitin 2016 subjekti ka rezultuar me një balancë pozitive 683,225 lekë.

13. Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se në lidhje me pasuritë e bashkëshortit të subjektit F. T., të deklaruar në deklaratën *Vetting* si vijon:

a) Automjeti tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2010 në vlerën 883,925 lekë, ku bashkëshorti i subjektit ka rezultuar me balancë negative në shumën -1,753,611 lekë për periudhën 2006 – nëntor 2010.

b) Dyqan/njësi me sip. 88 m², blerë në vlerën 70,000 euro, në datën 22.7.2014, ku bashkëshorti rezultoi me balancë negative – 6,281,377 lekë për periudhën dhjetor 2010 – 17.4.2014.

c) Depozitë në BKT në shumat 5,000 euro (për pjesën 2,274 euro) dhe 1,500,000 lekë, nga ku u konstatua balancë negative në shumën -623,709 lekë për depozitën 1,500,000 lekë dhe -2,274 euro në depozitën 5,074 euro, të krijuara me burim nga gjendja *cash* para lidhjes në martesë dhe para fillimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit – subjekti ka paraqitur dokumentacion të konsiderueshëm ligjor, që vërteton ushtrimin e aktivitetit tregtar nga ana e familjes së bashkëshortit dhe e bashkëshortit si pjesë e saj, por edhe veçmas.

13.1 Pas analizimit të fakteve, provave dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e subjektit përgjatë hetimit, Komisioni vlerëson se pasuritë e lartpërmendura të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë krijuar përpara martesë dhe përpara detyrës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni, duke vlerësuar edhe deklaratimet e subjektit dhe bashkëshortit të saj, i konsideron ato si pasuri vetjake, në posedim 100% të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

13.2 Komisioni, bazuar edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit⁶⁶, arrin në përfundimin se bashkëshorti F. T. nuk mund të klasifikohet në kategorinë e personit të lidhur apo tjetër të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e krijimit të këtyre pasurive. Bashkëshorti F. T. nuk ka pasur me subjektin e rivlerësimit marrëdhënie të asaj natyre, që përcaktojnë pikat 13 dhe 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përpara lidhjes së martesës me subjektin, si dhe para fillimit të detyrës nga ana e saj. Komisioni çmon se periudha në të cilën bashkëshorti i subjektit ka krijuar dhe ka poseduar pasuritë e lartpërmendura ka qenë përtej kohës kur subjekti dhe bashkëshorti ishin në kushtet e bashkësisë ligjore, pra kur nuk ishin të martuar dhe palët vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Nga hetimi administrativ nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të dispononte të drejta reale mbi këto pasuri, nuk rezultoi që si burim i këtyre pasurive të kenë shërbyer të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, gjithashtu nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime apo të ketë kryer transaksione bankare në lidhje me këto pasuri; nuk rezultoi gjithashtu që pasuritë e bashkëshortit të subjektit përpara martesë të kenë pasur ndikim financiar në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit,

⁶⁶ Vendimi nr. 15, datë 18.6.2021, për subjektin K. S.; vendimi nr. 19, datë 10.6.2022, për subjektin A. G.; vendimi nr. 20, datë 14.6.2022, për subjektin I. Gj.

aq më tepër që ato nuk kanë asnjë lidhje interesi/financiare edhe me familjen e origjinës së subjektit të rivlerësimit.

13.3 Sa më lart, Komisioni vlerësoi të mos kryejë dhe të mos arrijë në një përfundim financiar në lidhje me këto pasuri të krijuara para martesë dhe para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe në pronësi 100% të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Në këto kushte, në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me detyrimin që të provojë në këtë proces mundësitë e bashkëshortit të tij për të krijuar me burime të ligjshme këto pasuri.

14. Analiza financiare para fillimit të detyrës

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPFDP dy pasuri: gjendje *cash* 300,000 lekë (burim krijimi: të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës) dhe automjet në vlerën 200,000 lekë në vitin 2013 (burim krijimi: dhurim i bashkëshortit të ardhshëm).

Përshkrimi	2013	2014	14.9.2015	Total
Te ardhura	231,070	629,136	471,852	1,332,058
Të ardhura nga Magjistratura	131,070	629,136	471,852	1,232,058
Të ardhura nga dhurimi i b/sh 200,000	0			0
Të ardhura nga dhurimi i prindërve 100,000	100,000			100,000
Shpenzime	45,071	229,806	196,028	470,904
Shpenzime jetike për 1 person	35,256	219,998	158,862	414,116
Shpenzime udhëtimi	9,815	9,808	37,166	56,788
Pasuri	299,905	163,130	333,890	796,925
Automjet blerë në 12.2013	200,000			200,000
Gjendje cash DPFDP		0	300,000	300,000
Ndryshim likuiditeti bankë	99,905	163,130	33,890	296,925
Mundësi për kursime	-113,906	236,201	-58,066	64,229
Mundësi për kursime kumulative	-113,906	122,295	64,229	64,229

15. Analiza financiare pas fillimit të detyrës

Periudha	14.9-31.12.2015	2016
PASURI	1,165,692	51,789
Apartament me sip. 64m2, ndodhur ***	1,000,000	
Makinw M*** v.p 1992		
Dyqan 88.1 m2 ndodhur në ***		
Automjet M*** vp. 2003		
Ndryshim likuiditeti (Lik.në fund-lik.në fillim)	165,692	51,789
Likuiditet në fillim të vitit	2,207,963	2,373,655
Likuiditet në fund të vitit	2,373,655	2,425,443
DETYRIME	0	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,165,692	51,789
TE ARDHURA dokumentuar	1,853,708	3,390,816
Të ardhura nga paga si prokuror	455,738	1,089,734
Të ardhura nga PF furrë buke	200,000	1,668,797
Të ardhura si administrator në vep.tregtare	88,000	264,000
Të ardhura nga dhurimi i prindërve për ap.	1,000,000	
Të ardhura nga pensioni i F.T	51,618	177,510
Të ardhura nga pensioni i B.T	58,352	190,775
SHPENZIME	523,311	2,655,802
Shpenzime jetike	523,311	940,368
Shpenzime qiraje	0	156,000
Shpenzim tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë		559,434
Shpenzime për arredimin e dyqanit		1,000,000
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	2,373,655	2,425,443
Analiza dokumentuar	164,705	683,225

Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive gjatë detyrës dhe një balancë financiare minimale para detyrës, prej - 113,906 lekësh, e cila në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit vlerësohet me një peshë të papërfillshme në vendimmarrjen e Komisionit në lidhje me kriterin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

16. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 18.11.2022, të KDZH-së, dhe Grupi i Punës informon se:

- i) Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
- ii) Për subjektin e rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata.

Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur në përfundimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

17. Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP-ja) si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 14.1.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata.

17.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

17.2 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie sipas shtojcës që parashikon ligji. Nuk rezulton të ketë mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat, duke referuar si periudhë të rivlerësimit 1.1.2014 – 31.12.2016.

17.3 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti nr. 1 – Ankim kundër vendimit nr. ***, datë 15.11.2016⁶⁷, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti i rivlerësimit ka bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila në vendimin e saj ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e pjesës së pavuajtur të dënimit nga ana e të pandehurit, duke ia konvertuar në periudhë prove. Subjekti në ankimin e saj ka trajtuar shkaqet dhe arsyet mbi të cilat ka mbështetur ankimin e vendimit. Subjekti, ndër të tjera, ka argumentuar se në rastin e të pandehurit N. H. nuk plotësohej kriteri i rrezikshmërisë së ulët i veprës penale, nisur nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, duke sjellë në vëmendje faktin që vepra ishte kryer duke mbjellë 200 rrënjë *cannabis sativa* në afërsi të banesës së tij, një sasi që nga gjykata duhej vlerësuar e konsiderueshme dhe nuk mund të anashkalohej. Gjithashtu, marzhet e dënimit për

⁶⁷ Që i referohet çështjes me të pandehur N. H., i akuzuar për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes ka kërkuar: 1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit N. H. për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.* 2. *Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale – uljen e 1/3 të masës së dënimit.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2016, ka vendosur: 1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit N. H. për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.* 2. *Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal ka pezulluar ekzekutimin e pjesës së pavuajtur të dënimit, duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë kohore dy vjet.*

veprën penale në fjalë parashikojnë dënimin me burgim në maksimum deri në 7 vjet dhe se vepra penale kryhej vetëm me dashje direkte, forma më e rëndë e fajit. Subjekti ka argumentuar se aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e dënimit me burgim ishte në kundërshtim me përmbushjen e funksionit të dënimit penal etj.

Dokumenti nr. 2 – Konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. ***/2016, me të pandehur G. Gj. dhe L. Gj. Nga aktet ka rezultuar se në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë shtetasit G. Gj. dhe L. Gj. kanë goditur punonjësit e policisë Xh. Q. dhe E. V. dhe të pandehurit janë arrestuar në flagrancë për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik me dhunë në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti në konkluzione ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve dhe dënimin e tyre⁶⁸.

Dokumenti nr. 3 – Vendim mosfillimi për kallëzimin nr. ***/2016, me kallëzues shtetasin K. C. Nga aktet ka rezultuar se shtetasi E. H. është paraqitur në Komisarlatin e Policisë Vlorë për të kallëzuar faktin penal “goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal. Është bërë akti i ekspertimit mjekoligjor për shtetasin E. H., i cili është goditur me grusht nga shtetasi K. C. dhe ka rezultuar se konstatoheshin dëmtime, të cilat hynin në kategorinë e dëmtimeve të parëndësishme. Është bërë ndalimi i shtetasit K. C. nga policia dhe nga prokuroria është bërë lirimi i menjëhershëm. Është vendosur pushimi i procedimit penal, me arsyetimin se goditja ka ndodhur për shkaqe që nuk kanë lidhje me ushtrimin e funksionit publik, duke vlerësuar se bëhej fjalë për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal dhe për këtë i dëmtuari t’i drejtohej gjykatës për të drejtën e pretenduar.

Komisioni vëren se nga analizimi i dokumentacionit, ashtu sikurse edhe KLP-ja, nuk konstatohen problematika në lidhje me 3 dokumentet e zgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit.

17.4 Pesë dosjet penale të përzgjedhura nëpërmjet procedurës së shortit

Dosja 1 – Vendim mosfillimi procedimi penal, datë 2.12.2015, për kallëzimin penal nr. ***/2015⁶⁹. Subjekti i rivlerësimit në vendimin e saj ka argumentuar se nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera mungonin elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal dhe subjekti ka konkluduar se nuk mund të procedohej me regjistrim të procedimit, për sa kohë fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 290/1, shkronja “ç” dhe neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke njoftuar palët mbi vendimmarrjen. Dokumenti ligjor “vendim mosfillimi” është i strukturuar, janë respektuar rregullat drejtshkrimore, fjalitë

⁶⁸ 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G. Gj. për kryerjen e veprës penale “kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit L. Gj. për kryerjen e veprës penale “kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim. 3. Në caktimin e dënimit të aplikohet neni 406 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁹ Nga aktet në dosje ka rezultuar se pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë është paraqitur kallëzimi i bërë nga shtetasja E. M. për veprën penale “përndjekje” nga shtetasi S. D. Ajo ka shpjeguar se ka pasur lidhje intime me shtetasin S. D. dhe se është në proces gjyqësor me S. D. për njohje atësie, pasi ky i fundit ishte lidhur me dikë tjetër dhe nuk pranonte atësinë e fëmijës që kishin. Për këtë arsye, S. D. e kërcënonte me sms në Facebook, duke i thënë se do e vriste etj. Nga ana e OPGJ-ve janë këqyruar komunikimet në Facebook dhe ka rezultuar se E. M. dhe S. D. i janë drejtuar njëri-tjetrit me fjalë fyese, por nuk kanë rezultuar të dhëna për krijim gjendje ankthi apo frike për sigurinë vetjake apo të një të afërmi të tyre.

paraqiten të qarta dhe teksti i kuptueshëm, referohen norma të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, si dhe vendimi është i mirargumentuar.

Dosja 2 – Vendim pushimi procedimi penal, datë 19.1.2016, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal⁷⁰.

Mbi aktet e administruara gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se vepra penale e dyshuar ishte ajo e parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal: “*Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar, në tokën në pronësi të vet dënohet me burgim deri në 1 vit*”. Subjekti ka konkluduar se nuk plotësohej elementi i fajit i anës subjektive të veprës penale, i cili është i domosdoshëm për të pasur figurë të veprës penale dhe se për këtë qëllim është vendosur edhe pushimi i procedimit penal. I kallëzuar nuk ka pasur detyrimin të parashikonte se organi shtetëror do të gabonte në përcaktimin e saktë juridik të faktit apo për mungesën e koordinimit ndërmjet organeve shtetërore dhe nuk plotësohet elementi i fajit i anës subjektive të veprës penale, i cili është i domosdoshëm për të pasur figurën e veprës penale. Vendimi i pushimit u është njoftuar palëve. Nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim nga palët. Dokumenti ligjor “Vendim pushim procedimi penal” është i strukturuar, arsyetimi është ligjor e logjik, fjalitë paraqiten të qarta dhe teksti i kuptueshëm, referohen norma të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale si ligje organike të fushës, ku mbështetet vendimi.

Dosja 3 – Kërkesë për gjykimin e çështjes penale të procedimit nr. ***/2015 për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal⁷¹.

Në kërkesën për gjykim të dërguar nga subjekti në gjykatë dhe në konkluzione përfundimtare subjekti ka kërkuar: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit L. H. për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit N. L. për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 13.7.2017, e cila ka plotësuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim për një periudhë prove 6- mujore.

Dosja 4 – Kërkesë për gjykimin e çështjes penale të procedimit nr. ***/2015 për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal⁷².

⁷⁰ Nga verifikimi i akteve rezulton se shërbimet e policisë gjyqësore në datën 15.1.2016 kanë marrë informacion se në lagjen “***” të qytetit të Vlorës po ndërtohej mur pa lejen e organeve kompetente nga shtetasi Xh. M. Gjatë hetimit është administruar dokumentacioni nga Bashkia Vlorë dhe ka rezultuar se shtetasi Xh. M. ishte pajisur me shkresë nga Bashkia Vlorë, se në bazë të nenit 6, bazuar në VKM-në Nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 6 lloji i punimeve për riparimin e rrethimeve ekzistuese, nuk kërkonte pajisje me leje ndërtimi. Ka rezultuar se inspektorët e INUV-it, pasi kanë kryer verifikimet, kanë bërë pezullimin e punimeve të saponisura, duke lënë për detyrë që të pajisej me leje ndërtimi për vazhdimin e punimeve dhe me vendim të datës 26.1.2016 është dënuar me gjobë në masën 500,000 lekë shtetasi Xh. M. dhe me vendimin nr. ***, datë 11.3.2016, është marrë sanksioni administrativ i prishjes së objektit.

⁷¹ Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 6.11.2015 punonjësit e OSHEE-së Vlorë gjatë një kontrolli të ushtruar në një pallat në lagjen “I. B.”, tek kabina përkatëse kishte rilidhje të energjisë elektrike nga abonenti M. M. Abonenti ishte pajisur me kontratën përkatëse me matësin në momentin e konstatimit dhe ndërprerjes së energjisë elektrike. Fakti është pasqyruar në procesverbalin e ndërprerjes së energjisë elektrike, të përpiluar nga punonjësit e OSHEE-së. Nga hetimi ka rezultuar se banesa ishte në pronësi të shtetases E. D., e cila jetonte në Itali që prej vitit 2008 dhe banesën e kishte blerë shtetasi M. M. Që nga viti 2008 kjo banesë posedohej nga i pandehuri N. L., kunati i E. D. Shtetasi N. D. ka konsumuar tërësisht elementet e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Vepra penale ishte kryer nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme, duke ndërhyrë në aparatën matës të energjisë elektrike pa lejen e furnizuesit, veprime të kryera direkt me qëllim përfitimi material.

⁷² Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se ka bërë kallëzim shtetasi F. A., i cili ka shkuar në një lokal me disa kolegë të tij dhe ka lënë në karikim telefonin e tij. Pas 30 minutash, kur ka shkuar për ta marrë, ka gjetur vetëm karikuesin e tij dhe një telefon

Bazuar në rrethanat e rezultuara nga hetimi, subjekti ka arritur në konkluzionin se i pandehuri B. M. ka konsumuar tërësisht elementet e veprës penale “vjedhje”, e kryer nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme për të poseduar pasurinë e të dëmtuarit F. A.

Në kërkesën për gjykim dhe në konkluzione përfundimtare, subjekti ka kërkuar: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit B. M. për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen e dënimit me 1/3*”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 30.1.2017, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit B. M. për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 300,000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale zbritjen e 1/3 të dënimit për të pandehurin, duke e dënuar përfundimisht me 200,000 lekë gjobë. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.*

Dosja 5 – Kërkesë për gjykimin e çështjes penale të procedimit nr. ***/2016 për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal⁷³.

Pasi nga subjekti është dërguar kërkesa për gjykim, në konkluzione përfundimtare ka kërkuar: *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. H. për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike” dhe, në bazë të nenit 284/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale të ulet 1/3 e masës së dënimit.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 17.11.2016, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. H. për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet e 6 muaj burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale zbritjen e 1/3 të dënimit. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë prove 2 vjet. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 17.11.2016.*

Komisioni vëren se nga analizimi i dokumentacionit, ashtu sikurse dhe nga ana e KLP-së, nuk konstatohen problematika në lidhje me 5 dosjet e përzgjedhura me short.

17.5 Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore-vlerësimet)

a) Nga verifikimi në arkivin e KLP-së rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, nuk është iniciuar procedim disiplinor dhe nuk janë marrë masa disiplinore.

b) Nga përgjigjet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive të shkallës së parë rezulton se nuk ka pasur kallëzime apo procedime penale të filluara në ngarkim të prokurores, si dhe nuk rezultojnë ankesa.

c) Për vitin kalendarik 2016 subjekti Vitjuna Mata është vlerësuar “shumë mirë” me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

tjetër që po karikohej. Kallëzuesi ka pyetur kamerierin dhe personat e tjerë të pranishëm në lokal, por asnjëri prej tyre nuk kishte vënë re gjë. Në vendngjarje është pyetur edhe shtetasi B. M., i cili ishte personi që e kishte marrë me qira lokalin dhe, sipas tij, karikuesi është përdorur nga dikush tjetër për ta karikuar telefonin, por nuk ishte në gjendje ta identifikonte. Në kuadër të hetimeve është kërkuar informacion nga shoqëria telefonike V për të identifikuar thirrjet hyrëse dhe dalëse, si dhe kodin e aparatit telefonik, që kishte përdorur kartën SIM përkatëse në momentin e kryerjes së veprës penale. Nga informacioni rezultoi se në aparatit telefonik ishte përdorur edhe karta me numrin përkatës, që nga verifikimi i përkiste shtetasit B. M. Personi që posedonte numrin ishte shtetasja H. M., e cila shpjegon se kartën SIM me numrin përkatës ia ka dhënë djali i saj B. M.

⁷³ Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 23.7.2016 oficerët e policisë gjyqësore gjatë një kontrolli të ushtruar në bahçen e shtetasit L. H. kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale lëndë bimore *cannabis sativa*, gjithsej 800 rrënjë, me lartësi 1.2 - 1.7 metra. I pandehuri L. H. ka konfirmuar përpara oficerëve të policisë gjyqësore autorësinë e mbjelljes së bimëve narkotike. Gjithashtu, nga konkluzioni i aktit të ekspertimit i datës 9.8.2016 është konfirmuar se lënda e sekuestruar ishte bimë *cannabis sativa*. Nga analizimi i provave të administruara gjatë hetimit, subjekti me cilësinë e prokurorit të çështjes ka arritur në konkluzionin se i pandehuri L. H. kishte konsumuar tërësisht elementet e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal, kryer me veprime aktive nëpërmjet kultivimit të 800 rrënjëve bimë narkotike pa lejen dhe autorizimin sipas ligjit, me qëllim të përfitimeve financiare.

17.6 Aftësitë e treguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së saj si prokurore, si vijon:

- aftësi të mira profesionale (ku përfshihen njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor);
- aftësi të mira organizative (ku përfshihen aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjet);
- etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale (ku përfshihen etika në punë, integriteti dhe paanësia);
- aftësitë personale e angazhimi profesional (ku përfshihen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t'u angazhuar).

17.7 Të dhëna nga prokuroritë

17.7.1 Prokuroria e Përgjithshme⁷⁴ ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacionin e përcjellë nga të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore.

17.7.2 Prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (PPKKKO)⁷⁵ kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezultojnë të jenë depozituar kallëzime apo procedime në ngarkim të subjektit Vitjuna Mata.

17.8 Denoncimet/ankesat nga publiku

Ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, nuk është depozituar asnjë denoncim/ankesë nga publiku.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata:

- a) Ka kryer deklaram të saktë të pasurisë dhe në përputhje me ligjin, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, të cilat konsiderohen si pasaktësi që nuk sjellin vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit.

Nga analiza financiare rezultojnë se me të ardhurat e fituara subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara pas fillimit të detyrës nga ana e subjektit dhe vetë subjekti rezultojnë me një balancë financiare minimale para detyrës, prej -113,906 lekësh, e cila në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit vlerësohet me një peshë të papërfillshme në vendimmarrjen e Komisionit në lidhje me kriterin e pasurisë.

Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe

⁷⁴ Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021.

⁷⁵ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë me nr. *** prot., datë 5.3.2021; Kavajë me nr. *** prot., datë 10.3.2021; Pukë me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Berat me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Mat me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kurbin me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Tropojë me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Përmet me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Gjirokastrë me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kukës me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Fier me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Sarandë me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Korçë me nr. *** prot., datë 26.2.2021; Shkodër me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Pogradec me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Dibër me nr. *** prot., datë 23.1.2021; Lezhë me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Lushnjë me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Tiranë me nr. *** prot., datë 19.2.2021; Elbasan me nr. *** prot., datë 1.3.2021; Durrës me nr. *** prot., datë 17.2.2021 dhe PPKKKO me nr. *** prot., datë 12.2.2021.

mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- b) Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Vitjuna Mata, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 20.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj